

UNIVERSITETI I EJL

FAKULTETI I DREJTSISË

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈИЕ

ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

UNIVERSITY OF SEE

FACULTY OF LAW

STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

KAPACITETET E DECENTRALIZIMIT DHE TË TRANSPARENCËS SË QEVERISJES LOKALE NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT-STUDIM RASTI:

KOMUNA E STUDENIÇANIT

KANDIDATI:

MENTORI:

XHELAL ZEQRIRI

PROF.DR.JETON SHASIVARI

SHKUP,NËNTOR-2020

DEKLARATË

Une Xhelal Zeqiri deklaroj dhe vertetoj se une jam autor original I ketij punimi te magjistratures me titullin:”**Kapacitetet e Decentralizimit dhe te transparences se Qeverisjes Lokale ne Republiken e Maqedonise se Veriut-Rast Studimi:Komuna e Studenicanit**” dhe te gjitha referncat e shenuara ne kete punim si dhe citimet apo sherbimet e ndryshme te marrura nga burimet e ndryshme materiale apo elektronike jane te shenuara me fusnota dhe ne fund tec do faqjeje si dhe ne fund te ketij punimi.Me kete rast,poashtu deklaroj se Univerzitetit ia barti te gjitha te drejtat autoriale te ketij punimi,per qellime edukative-arsimore dhe hulmtuese.

PËRMBAJTJA	3
Abstrakt/ АПСТРАКТ/Abstract	4
HYRJE11
KAPITULLI I PARË	12
DECENTRALIZIMI I QEVERISJES LOKALE NË RMV	12
1.1Kuptimi I qeverisjes lokale.....	12
1.2Koncepti kushtetues I qeverisjes lokale në RMV.....	16
1.3Koncepti ligjor I qeverisjes lokale në RMV.....	19
1.4Qeverisja lokale në RMV pas marveshjes kornizë të Ohrit.....	22
1.5Organizimi territorial I qeverisjes lokale në RMV.....	24
1.6Procesi I decentralizimit të kompetencave të qeverisjes lokale në RMV.....	29
KAPITULLI I DYTË	32
KOMPETENCAT KOMUNALE,ORGANET E QEVERISJES LOKALE DHE DEMOKRACIJA LOKALE NË RMV32
2.1Kompetencat komunale të qeverisjes lokale në RMV.....	32
2.2Organet e qeverisjes lokale në RMV.....	.38
2.2.1Keshlli I komunës.....	38
2.2.2Kryetari I komunës.....	41
2.3Dominimi I fuqisë së kryetarit të komunës në strukturën e kompetencave komunale.....	42
2.4Raportet midis pushtetit qendror dhe lokal.....	46
2.5Demokracija lokale dhe transparenca.....	50
2.5.1Iniciativa qytetare.....	50
2.5.2Tubimi I qytetarëve.....	51
2.5.3Referendumi.....	51
2.6Mbrojtja juridike kushtetuese e autonomies lokale në RMV.....	52
KAPITULLI I TRETË	58
KAPACITETET E DECENTRALIZIMIT DHE TRANSPARENCËS SË KOMUNËS SË STUDENIÇANIT ..	58
3.1Struktura territoriale dhe historiku I komunës së Studeniçanit.....	60
3.2Profili I komunës së Studeniçanit.....	62
3.2.1Kryetari I komunës.....	62
3.2.2Keshilli I komunës.....	65
3.2.3Administrata komunale.....	73
3.2.4Ndermarrjet dhe institucionet publike.....	76
3.2.5E-komuna:Buxhetet e komunës(2017-2020)dhe llogarit përfundimtare të komunës....	80
3.3Analizo statutin e komunës.....	88
3.3.1Anketimi I qytetarve dhe I zyrtarve komunal.....	89
3.3.2 Analiza e anketimit për banorët e komunës së Studeniçanit.....	90
3.3.3 Analiza e anketimit për zyrtarët komunal të komunës së Studeniçanit.....	91
3.3.4 Intervista me kryetarin.....	92
KONKLuzionET	95
BIBLIOGRAFIA	98

Abstrakti

Ky hulumtim ndërlidhet kryesisht me pushtetin lokal, si njësi e vetëqeverisjes lokale, gjegjësisht, hulumtimi bazohet mbi dhënien e një pasqyre sa më konkrete të organizimit dhe funksionimit të Komunës së Studeniçanit, e cila shtrihet në pjesën veriore të Maqedonisë së Veriut në Shkup. Në këtë punim, do të mundohemi të gjejmë shkaqet që ndikojnë në njësinë e vetëqeverisjes lokale, kryesisht në Komunën e Studeniçanit dhe të gjejmë forma të reja të organizimit, si dhe faktorët të cilët ndikojnë në funksionimin e drejtë të kësaj komune. Qëllimi i këtij punimi është më tepër praktik se sa teorik duke pasur parasysh se theksimi i disa çështjeve me rëndësi si bashkëpunimi ndërkombëtar si dhe marrëdhëniet ndërmjet Komunës së Studeniçanit dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut por edhe më gjërë do të jetë objekti kryesor i këtij punimi, kuptohet gjithmonë brenda kompetencave të komunës së përcaktuara me ligj dhe me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj dhe të cilët janë pjesë e rendit të brendshëm juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pra, me një fjalë punimi mëton të tregojë mbi qëllimin e bashkëpunimit, fushën dhe kompetencën për të cilën janë paraqitur, implikimet e mundshme financiare dhe përfitimet e një bashkëpunimi të tillë si dhe çështje tjera me rëndësi për krijimin e bashkëpunimit ndërkombëtarë. Në punim, të dhënat gjithashtu do të jenë të prezantuara në mënyrë tabelare si dhe me statistika të ndryshme, kështu duke dhënë për lexuesit një pasqyrë sa më të qartë dhe më konkrete mbi Komunën e Studeniçanit.

Fjalët kyçe: Komuna e Studeniçanit, organizimi, kompetenca, bashkëpunimi, financat;

АПСТРАКТ

Ова истражување главно се однесува на локалната самоуправа, како единица на локалната самоуправа, имено, истражувањето се заснова на давање поконкретен преглед на организацијата и функционирање на Општина Студеничани, која лежи во северниот дел на Македонија Север во Скопје. Во овој труд, ќе се обидеме да ги пронајдеме причините што влијаат на единицата на локална самоуправа, главно во Општина Студеничани и да најдат нови форми на организација, како и факторите кои влијаат на правилното функционирање на оваа општина.

Целта на овој труд е попрактична отколку теоретска со оглед на тој акцент на некои важни прашања како што се меѓународната соработка, како и односите помеѓу Општина Студеничани и Владата на Република Северна Македонија но и повеќе широк ќе биде главниот предмет на овој труд, секогаш разбран во рамките на надлежностите на општина дефинирана со закон и со меѓународни договори ратификувани со закон и кои се дел од

внатрешниот правен поредок на Република Северна Македонија. Значи со а работниот збор има за цел да ја посочи целта на соработката, полето и компетентноста заради што се презентирани потенцијалните финансиски импликации и придобивките од таквата соработка како што се и други прашања релевантни за воспоставување на меѓународна соработка. Во трудот, податоците исто така, ќе бидат презентирани во табеларна форма, како и со различни статистички податоци, на тој начин давајќи им на читателите појасен и поконкретен преглед на Општина Студеничани.

Клучни зборови: Општина Студеничани, организација, надлежности, соработка, финансии;\

Abstract

This research is mainly related to local government, as a unit of local self-government, ie the research is based on giving a more concrete picture of the organization and functioning of the Municipality of Studenicani, which lies in the northern part of Northern Macedonia in Skopje. In this paper, we will try to find the causes that affect the local self-government unit, mainly in the Municipality of Studenicani and find new forms of organization, as well as factors that affect the proper functioning of this municipality.

The purpose of this paper is more practical than theoretical, given that the emphasis on some important issues such as international cooperation and relations between the Municipality of Studenicani and the Government of the Republic of Northern Macedonia and beyond will be the main object of this The work is always understood within the competencies of the municipality defined by law and by international agreements ratified by law and which are part of the internal legal order of the Republic of Northern Macedonia. So, in a word, the paper aims to show the purpose of cooperation, the field and competence for which they are presented, the possible financial implications and benefits of such cooperation as well as other important issues for the establishment of international cooperation. In the paper, the data will also be presented in tabular form as well as with different statistics, thus giving the reader a clearer and more concrete picture of the Municipality of Studenicani.

Keywords: Studenicani Municipality, organization, competence, cooperation, finance;

HYRJE

Qeverisja lokale është një kategori e sistemit kushtetues dhe politik të një vendi, por nuk ka të njëjtin pozicion dhe kuptim në të gjitha shtetet në të cilat ekziston. Sirezultati kësaj përkufizohet ndryshe nga autorë të shumtë në literaturën kushtetues juridike. Qeverisja lokale është një bashkësi territoriale në të cilën njerëzit së bashku, me forcat e përbashkëta, përpiqen në çdo mënyrë të mundshme të zgjidhin problemet me të cilat përballen dhe ta bëjnë jetën e tyre shumë më të thjeshtë. Në fakt, vetë qytetarët në mënyrë të pavarur, direkt ose përmes organeve të tyre përfaqësuese vendosin për ato çështje që kanë interes publik dhe rëndësi lokale. Qeverisja lokale përbëhet nga popullsia lokale në një komunitet që zgjedh autoritetet lokale dhe u jep atyre mbështetje të plotë, por në kthim pret që qeverisja lokale të zgjidhë problemet me të cilat përballen çdo ditë ose në baza të përbashkëta. Autoritetet lokale, nga ana tjetër, kanë burime të caktuara financiare për kryerjen e veprimtarive që janë në kompetencën e tyre, dhe janë në interes të vetë qytetarëve. Sidoqoftë, nëse pyesim veten nëse qeveria e shtetit mund të menaxhojë zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë, apo nevojitet një funksionim dhe veprim i një qeverisje tjetër, përgjigjja do të ishte që autoritetet shtetërore nuk mund të mbulojnë tërë territorin, por atyre u duhet një qeverisje tjetër alternative ndaj së cilës do të transferohen disa nga kompetencat që ata do ti kryejnë, dhe në të cilat shfaqen disa dobësi funksionale, d.m.th. ku mund të paraqiten punë joefikase. Kjo do të thotë që në disa pjesë të zhvillimit shoqëror ka nevojë të prezantohet qeverisja tjetër alternative, përkatësisht ajo lokale për të cilën do të flasim në këtë Tezë të MA.

Pushteti lokal ka një aftësi të madhe dhe mund të përshtatet me karakteristikat specifike të një zone dhe të japë përparësi dhe kontribute për ato çështje më të rëndësishme për qytetarët, sesa që mund këtë ta bëjë qeveria e shtetit, nëse kryen të njëjtat përgjegjësi sikurse pushteti lokal.

Qëllimet e hulumtimit

Arsyet përse e kam zgjedhur këtë temë për tezë të magjistraturës kanë të bëjnë me faktin se organizimi dhe funksionimi i sistemit në nivelin e qeverisjes lokale-pushtetit vendor, është i rëndësishëm për çdo shtet, e në veçanti për shtetet me sistem bashkëkohor demokratik. Për një kohë të gjatë, por edhe aktualisht, kjo është fushë interesimi i shumë teoricienëve të ndryshëm, e në rend të parë për konstitucionalistët dhe politologët. Në pjesën më të madhe të shteteve dhe në teorinë shkencore, trajtimi i konceptit të qeverisjes lokale është sinonim i autonomisë lokale, përkatësisht qeverisjes në nivelin e njërive të organizimit territorial të këtij pushteti pa prerogativa të pushtetit shtetëror, domethënë është organizimi i pushtetit në nivelin e komunës, bashkisë, rajonit, qytetit, provincës. Pa marrë parasysh rregullimin politik, ky nivel i organizimit të pushtetit dhe funksionimi i tij është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm politik e çdo shteti, si dhe organizohet në të gjitha shtetet.

Disa nga shtetet më të zhvilluara të Evropës Perëndimore gëzojnë tashmë një kulturë shumëshekullore në sistemin e vetëqeverisjes lokale. Këto shtete janë pikërisht ato, që kanë krijuar sistemin shumëpartiak parlamentar demokratik, si dhe atë të qeverisjes lokale në parimet demokratike. Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe ato të Ballkanit Perëndimor ku bën pjesë edhe Maqedonia e Veriut, organizimin dhe ndërtimin e këtij niveli të pushtetit në parimet demokratike e filluan pas ndryshimeve të mëdha, që ndodhën në fund të shek. XX. Pra, me ndryshimet strukturore në rrafshin politik, ideologjik, ekonomik, kulturor dhe social, duke kërkuar rrugë dhe alternativa decentralizuese të këtyre sistemeve. Kështu, me ndryshimet kushtetuese, të akteve e ligjeve të veçanta mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale-pushtetit vendor, këto shtete përqafuan parimet demokratike evropiane në tërë korpusin politik e në veçanti parimet që dalin nga Karta Evropiane për Qeverisjen Lokale “European Charter of Local Self- Government”, e miratuar nga Këshilli i Evropës më 1985, në Strasburg të Francës.

Me ratifikimin e Kartës Evropiane për Qeverisjen Lokale, çështja e organizimit, e funksionimi dhe e kompetencave të njërive të qeverisjes lokale i tejkaloi kornizat e sistemit të brendshëm të vendit të caktuar. Përcaktimi kushtetues dhe rregullimi ligjor i këtij sistemi tani nuk mund të

konsiderohet si e drejtë ekskluzive e sistemit të brendshëm politik, apo si çështje e brendshme e një vendi, duke marrë në konsideratë edhe faktin, që, tani, ky sistem përmban edhe premise ndërkombëtare.

Sistemi i qeverisjes lokale nuk është një koncept abstrakt, por konkret dhe publik, i cili bazohet dhe ndërtohet mbi faktorë përcaktues për organizimin dhe funksionimin e një njësie të vetëqeverisjes lokale, siç janë: territori i caktuar, konfiguracioni gjeografik dhe qytetarët.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të parashtrijë dhe të shtjellojë në mënyrë teorike dhe empirike konceptin dhe funksionimin e qeverisjes lokale në RMV si dhe të ofrojë zgjidhjet normative (ligjore) të kapaciteteve decenralizuese në RMV si dhe të transparencës në punën e qeverisjes lokale, me vështrim të posaçëm në Komunën e Studeniçanit.

Ky hulumtim mund t`u shërbejë edhe autoriteteve lokale dhe qendrore, si bazë e mirë teorike dhe empirike për të kuptuar drejtë rolin e tyre kushtetues dhe ligjor, që kanë në mes tyre, si dhe në raport me qytetarët në përgjithësi për zhvillimin dhe funksionimin e qeverisjes lokale.

Hipotezat

Gjatë këtij hulumtimi shkencor do të paraqesim disa hipoteza, të cilat gjatë përpunimit të tezës do të vërtetohen.

Hipotezat e punimit janë:

Hipoteza gjenerale:

- Qeverisja lokale në RMV me procesin e decentralizimit, ka fituar kompetenca të shtuara në rrafshin lokal.

Hipotezat e veçanta:

- Cila është korniza normative (kushtetuese, ligjore dhe statutare) e transparencës së qeverisjes lokale në RMV, në veçanti e Komunës së Studeniçanit.

- Rritja e transparencës së Qeverisjes lokale, në veçanti e Komunës së Studeniçanit, e rrit besimin e qytetarëve në institucionet e saj.

- Cili është niveli i publikimit të të dhënave të sektorit publik në rrafshin lokal në Komunën e Studeniçanit.

- Në përgjithësi Komuna e Studeniçanit ofron një transparencë të pjesshme, llogaridhënie minimale, me mundësi të kufizuara të komunikimit elektronik interaktiv me qytetarët.

Metodologjia e hulumtimit

Për kryerjen e studimit do të përdoren metodat si vijon:

- Metoda historike;
- Metoda krahasuese;
- Metoda e studimit të rastit;
- Metoda juridike;
- Metoda statistikore;

Në elaborimin e kësaj teme do të shfrytëzohen të dhëna të ndryshme nga institucionet relevante në vend si dhe të publikimeve të ndryshme, revistave si dhe burimeve tjera juridike.

Rëndësia e punimit

Pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin e politikave lokale dhe aftësia për të ndikuar në formësimin dhe përmirësimin e vendimeve që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës në komunitetin lokal janë parakushtet kryesore për qeverisjen demokratike në nivelin lokal. Në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin pjesë me iniciativat dhe propozimet e tyre, qytetarët duhet të jenë në gjendje të përdorin lirshëm të dhënat dhe informacionet dhe i shpërndajnë ato me qytetarët e tjerë. Roli i autoriteteve dhe administratës vendore në këtë proces të ndërtimit të dialogut politik të hapur dhe pjesëmarrës përfshin gjetjen e qasjeve inovative që do të forcojnë përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës në vendimmarrje që, nga ana tjetër, parasheh politika më të mira, stimulon vendime dhe mbështetje nga komuniteti në zbatimin e tyre. Nga ky kontekst i proceseve demokratike në krijimin e politikave lokale, në realitetin konkret të shoqërisë në RMV lindin dy pyetje thelbësore: (1) sa pushteti vendor dhe administrata lokale përmes të dhënave dhe informacionit që kanë, janë të hapura për të ndikuar në interesat e shoqërisë; (2) cilat të dhëna dhe informacione u duhen qytetarëve për ta arritur atë ndikim, ndërsa monitorojnë se çfarë prodhon politika, d.m.th. nëse politikat lokale përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve dhe në çfarë mase?

Sigurisht, sot, përpjekjet për të modernizuar qeverisjen lokale, dhe duke përfshirë qytetarët në ndërtimin e politikave dhe shërbimeve më efikase, duhet të marrin parasysh mënyrat novatore të komunikimit të imponuara nga zhvillimi i teknologjive të informacionit, në krahasim me mekanizmat tradicional të këshillimit dhe komunikimit me qytetarët.

Transparenca, përgjegjësia-llogaridhënia dhe pjesëmarrja e qytetarëve në një demokraci moderne duhet të mundësojnë që impulset dhe idetë e jashtme të merren parasysh gjatë zgjidhjes së problemeve komplekse në shoqëri. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje e bën sistemin kushtetues të vendit më demokratik dhe gjithëpërfshirës. Kjo qasje inkurajon iniciativën e qytetarëve për mobilizimin dhe përfshirjen në procesin politik dhe rivendosjen e besimit tek institucionet. Për administratën, kjo do të thotë mundësi më të mëdha për kapacitetet institucionale që mund të sjellin ndryshime të rëndësishme në të ardhmën.

KAPITULLI I PARË DECENTRALIZIMI I QEVERISJES LOKALE NË REPUBLIKEN E MAQEDONISË SË VERIUT

1.1 Kuptimi I qeverisjes lokale;

Në fillim të shqyrtimeve janë te nevojshme disa njohuri të përgjithsme për kuptimin e sistemeve të qeverisjes dhe të procesit historic të zhvillimit të tyre.

Përvetësimi i termit qeverisje në rast të parë ka rëndësi të veçantë.

Ricard.Hardly, sistemin e qeverisjes e percaktonte si bashkrendim të katër komponentëve përbërës ndër këto komponente ai theksonte popullin, pa të cilin nuk mund të ketë qeverisje, “Territorin” në të cilën jeton ai popull vetë qeverisjen dhe sovranitetin.

Në librin e tij “Historija për sistemet e qeverisjes”.

Përshkak të mundësisë së “Ngatrimin të termeve dhe të ngatrimin që ndodh në praktik”, vlen që në fillim të shqyrtimeve të bëhet dallimi midis termave “Qeveri dhe Qeverisje” Qeverija ka “kuptimin e ushtrimit të pushtetit ekzekutiv dhe kështu kuptimi më i përgjithshëm isaj. Në fakt qeverija krijohet nga një forcë politike e caktuar dhe ajo si rregull mban vulën e kryeministrit dhe emërtohet me emrin e tij.

Qeverisja është kuptim më i gjërë se qeverija.

Qeverisja shtrihet në tri hallka ose degëzime të cilat janë të pranishme në të gjitha sistemet.

Shqyrtime për qeverisjen po marrin përmasa gjithnjë e më të mëdha.

Në të vërtetë ato po pretendojnë që qoftë në gjërësi, qoftë në thellsi të përfshijnë elementet dhe qështjet që i referohen.¹

1. Organizimit të qeverisjes,

2. funksionimit të qeverisjes

3. kontrollit të punës së organeve dhe organizatave në sistemin e qeverisjes

Kur bëhet fjalë për organizimin e qeverisjes si element përbërës i objektit të shkencës mbi qeverisjen, një numër i madh pyetjesh kërkojnë përgjigje.

Pikëspari është e nevojshme që të bëhet fjalë për teorinë e sistemit të qeverisjes.

¹ Agni Aliu&Esat Stavileci”Qeverisja lokale”Prishtin2009 faqe 17

Përkëtë qëllim duhet sqaruar nocionin e sistemit dhe të nënsistemit, natyrisht dhe parimet e tyre si dhe klasifikimin që nënkupton llojet dhe strukturën e teorive të sistemit.

Në kuader të organizimit të qeverisjes vendë të merituar duhet të ketë teoria e organizatës. Fillimisht do të jepet nocioni i organizatës, meqë rast dotë paraqitet pikepamjet e ndryshme mbi këtë nocion sadotë qartësuar ende të diskutueshëm.

Dotë bëhet fjal për mundësitë e klasifikimit të organizatës si dhe të elementeve të saj natyrisht se nuk dotë ngelin anash as parimet e organizatës.

Qeverisja përbehet nga një numër i madh i aksioneve qeverisëse dhe zbatimi i atyre aksioneve. Qeverisja është e domosdoshme jo vetëm për funksionimin normal të sistemit por edhe për sigurimin e zhvillimit të tij.²

Në bazë të elementeve që e përkufizojnë qeverisjen mundë të nxirret si përfundim se kure behet fjal për qeverisjen mendohet për të gjitha ato aktivitete që domosdo duhet të ndermirren për realizimin e qëllimeve përkatëse në një organizat ose shoqëri në përgjithsi.

Qeverisja zbatohet në sisteme të ndryshme dhe ki është shkas për të konstatuar se ajo mund të vështrohet në dy kuptime të veta themelore.

Qeverisja në kuptimin e gjërë dhe qeverisja në kuptimin e ngushtë.

Shqyrtimet përqendrohen në kuptimin e gjërë të qeverisjes kuptim ky që mund të zbërthehet në:

1. Qeverisjen territoriale, me organizimin të ndryshëm dhe shkallë të ndryshëm
2. Qeverisje funksionale me organizimin të ndryshëm dhe në fusha të ndryshëm të jetës
3. Qeverisjen asociative kaluese mikste ose paternaliste

Qeverisja në kuptimin e ngushtë shtrihet në proceset përkatëse të punës dhe ajo nuk paraqet objekt të shqyrtimeve tona.

Vëmendje e veqante i kushtohet qeverisjes territoriale e cila paraqet një proces shumë të përbërë nga më shumë funksione përkatësisht veprimtari.

Sipas autoreve përendimor egziatojn tri veprimtari themelore të shtetit të cilat i përmbledh procesi i qeverisjes dhe ato sipas tyre janë:

² Agni Aliu&Esat Stavileci "Qeverisja lokale" Prishtinë 2009 faqe 18

1.Veprimtarija legislative

2.Veprimtarija egzekutive

3.Veprimtarija gjyqësore

Ka autor qe behen fjal edhe per “veprimtarin administrative” Tre veprimtari themelore të shtetit mundë të zërthehen si numer edhe në me shume veprimtari perkatesisht funksione si rregull bëhet fjal për këto funksione:

Funksioni politik,funksionin egzekutiv,funksioni administrative,funksionin gjyqësore dhe funksionin e ndjekjes publike do të theksojmë disa nga karakterisitikat e secilit nga keto funksione.

Funksioni politik I shtetit është në fakt funksion I caktimit te politikës dhe ki funksion buron nga funksioni ligjvënës sepse perbëhet nga nxjerja e vendimeve themelore me te cilat caktohet qellimi I aksionit të njesis teritoriale të caktuar.

Ato vendime shprehen në formë të akteve kushtetuese, ligjore dhe të akteve të tjera.³

Veprimtarija egzekutive në kuptimin e pergjithshem është një por si veprimtari komplekse perbëhet nga kujdesi për realizimin e politikës të cilën e ka percaktuar organi legjislativ zbatmi I ligjeve dhe akteve te tjera të këti organi si dhe nga percaktimi dhe drejtimi I punës së organeve të administratës.

Funksioni administrativ buron nga funksioni egzekutiv në të vërtet ki funksion shprehet si funksion egzekutiv.

Aktiviteti egzekutiv I administratës manifestohet me zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera të organit legjislativ nepermjet akteve të administratës si dhe ushtrimit të veprimtaris repressive. Mbykqirja administrative shprehet si mbykqirje instancionale,mbykqirje mbi ligjeshmerin e punës së organizmave jo shtetore dhe si mbykqirje inspeksionale.

Veprimtarija gjyqësore shtrihet në zgjidhjen e konflikteve te cilët shfaqen me rastin e konkretizimit dhe të zbatimit të vendimeve themelore me të cilat percaktohet politika e njësis teritoriale të caktuar, ki funksion ju besohet organeve te specializuara.

³ Agni Aliu&Esat Stavileci”Qeverisja lokale”Prishtin2009 faqe 19

Veprimtaria e ndjekjes publike shtrihet ne ndermarjen e masave perkatëse për mbrojtjen e interesave të njësis teritoriale të caktuar dhe për përdorimin e mjeteve juridike me qëllim të mbrojtjes së kushtetuesmeris dhe ligjeshmeris.

Shqyrtimet për qeverisjen pergjithsisht bartën natyrshem mbi qeverisjen lokale që paraqet objekt studimi në këtë liber sipas fjalorit politik te Oxfordit,qeverisja lokale ose vendore është institucion qeverisës që ushtron autoritetin në një zonë teritorialisht të përcaktuar të vendit.

Me gjith ketë perkufizim të përgjithshëm të qeverisjes lokale egzistojn pykпамje të ndryshme rreth përcaktimit të qeverisjes lokale problemet janë edhe të natyrës metodologjike,shqyrtimet në këtë libër përqëndrohen edhe në qeshtje të terminologjisë.⁴

Megjithë pykëpamjet e ndryshme që shpien në përkufizimet e qeverisjes vendore mundë të përmbliidhen disa nga faktoret më dominantë që mundë të ndihmojnë të përqafohen nje kuptim më I pergjithësuar I qeverisjes lokale.

1.Meqë parimet e qevisjes lokale përmbliidhën në aktet kushtetuese qeverisja lokale padyshim paraqet kategori të së drejtes kushtetuese.

2.Qeverisja lokale nmenkupton te drejtën e qytetarve që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të mëvetësishme të vendosin qeshtjet me interes për njësin e vet teritoriale.

3.E drejta e qytetarve shtrihët në zgjidhjen dhe kontrollin e institucioneve të veta lokale.

4.Organet lokale gëzojnë kompetencat eveta.

5.Mardheniet e institucioneve të qeverisjes lokale me pushtetin qendror karakterizohën me kontrollin e tij të ligjshmërisë së punës së institucioneve lokale.

6.Njësija e qeverisjes lokale disponon me mjetet e veta dhe të drejtën e destiminimit të tyre.

Nuk mendojmë se ka një përkufizim të qeverisjes lokale të pranueshëm për të gjithë.

Edhe në legjislacionet e vendeve të ndryshme ndeshim në përkufizimet e nocioneve të veqanta në mënyrë që të mësohet se qka dmth qka.⁵

Nëkuptimin më të përgjithshëm ai mision ka synim sigurimin e qeverisjes në një nivel sa me afër të qytetarve.Misioni I pushtetit lokal shperfaqet në forma të ndryshme si respektim I të drejtave themelore të qytetarve të sanksionuara në kushtetut ose në ligje,zgjedhja e llojeve të ndryshme

⁴ Agni Aliu&Esat Stavileci"Qeverisja lokale"Prishtin2009 faqe20

⁵ Agni Aliu&Esat Stavileci"Qeverisja lokale"Prishtin2009 faqe 23

të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike lokale, ushtrimi efektiv i funksioneve kompetencave dhe realizimi i detyrave nga organet e qeverisjes lokale, realizimi i shërbimeve në formë të pershtatshme, nxitja efektive e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen lokale etj.

1.2 Koncepti kushtetues i qeverisjes lokale në RMV

Qeverisja lokale në RMV paraqet materie kushtetuese, me që kushtetuta e RMV-së qeverisjes lokale e përcakton si vlerë themelore të rendit kushtetues si dhe i kushton një kapitull të tërre keti lëmi, edhe atë kapitullin e pestë (dispozitat e nënve 114-117) ku përcaktohet pozita kushtetuese e qeverisjes lokale në sistemin politik të vendit.

Kushtetuta përcakton se qytetarëve u garantohet e drejta e qeverisjes lokale.

Njësitë e qeverisjes lokale janë komunat dhe qyteti i Shkupit si njësi e veçantë, ku mundë të themelohet forma të qeverisjes vendore, komunat dhe qyteti i Shkupit finansohen nga burimet vetanake nga të hyrat e caktuara me ligj dhe me mjete nga republika.

Nderkaqe me amendamentin XVI të v.2000 për kushtetutën e RMV –së përcaktohet se qeverisja lokale rregullohet me ligj që miratohet me shumicë prej 2/3 të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve me që rast duhet të ketë edhe shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë komuniteteve jo shumicë në RMV, ku siq shihet qëllimi i kushtetutdhënësit është që të mbrohet qeverisja lokale nga majorizimi etnik dhe voluntarizmi politik i nderhyrjes së ligdhënësit në sferën lokale të qytetarëve.

Ligjet për finansimin lokale, zgjedhjet lokale kufitë komunalë dhe për qytetin e Shkupit, Miratohen me shumicën e votave nga deputetët e pranishëm me që rast duhet të sigurohet edhe shumica e votave të deputetëve të pranishëm të cilët u takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në RMV.⁶

Nga ana tjetër me amendamentin XVII pika 1 të v-2001 për kushtetutën e RMV që rregullon kompetencat e qeverisjes lokale përcaktohet se në njësitë e sajë, qytetarët drejtpërdrejtë dhe në përmjet përfaqësuesve marrin pjesë në vendimarrje për çështjet me rëndësi lokale, dhe veqenarisht në lëmitë e shërbimeve publike, urbanizimit dhe planifikimit rural, mbrojtjes së mjedisit jetësorë, zhvillimit ekonomik, lokal, finansimit lokal, veprimtarive komunale, kultures, sportit

⁶ Prof. Dr. Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" Shkup 2020 faqe 315

mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve,arsimit,mbrojtjes shëndetsore dhe në lemenjte e tjera të caktuara me ligj,me crast përcaktimi kushtetues I kompetencave te qeverisjes lokale nuk është përfundimtarë dhe mundë të plotësohet edhe me ligje.Po ashtu me amandamentin XVII pika 2 të v-2001 për kushtetutën e RMV –së rregullohen kompetencat e qytetit të Shkupit si njësi e veqantë e qeverisjes lokale,dhe përcaktohet se në qytetin e Shkupit qytetarët drejtëpërsëdrejti dhe në përmjet përfaqësuesve marin pjesë në vendimmarje për qështjet me rëndesi lokale,e veqanërisht në lemenjtë e shërbimeve publike,urbanizmit dhe planifikimit rural,mbrojtjes së mjedisitjetësor,zhvillimitekonomikëlokal,finansimitlokal,veprimtarivekomunale,kultures,sportit, mbrojtjes sociale dhe të femijëve,arsimit,mbrojtjes shëndetsore dhe ne lemenjte e tjerë të caktuara me ligj.⁷

Pra lidhur me konceptimin kushtetues të qeverisjes lokale në RMV,mundë të rrezimohet se kushtetuta e RMV-së:

- 1.garanton te drejtën e qytetarëve për qeverisjen lokale
- 2.themelon komunat si njesitë të qeverisjes lokale
- 3.parashikon që format e qeverisjes vendore mundë të vendosen mbrenda komunave
- 4.garanton autonominë e komunave në kryerjen e kompetencave të përcaktuara me kushtetut dhe ligj.
- 5.garanton që komunat të kenë burime financiare si dhe financim nga shteti.
- 6.promovon demokracinë lokale të drejtëperdrejtë dhe përfaqesuese.
- 7.percakton qytetin e Shkupit si njësi të veqantë të qeverisjes lokale,organizimi I të cilit rregullohet me ligj të veqantë.

Vetëqeverisja lokale e Republikës së Maqedonisë është materie kushtetuese.

- 1 Ajo është vlerë themelore e rregullimit kushtetues.
- 2 3 Në pjesën e pestë të Kushtetutës me titullin “ Vetëqeverisja lokale “, parimisht është e vërtetuar pozita e saj kushtetuse në sistemin politik të Republikën e Maqedonisë.
- 3 4 Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, kushtetuta ua garanton të drejtën e vetëqeverisjes lokale , duke e vërtetuar karakterin demokratik të vetëqeverisjes lokale.

⁷ Prof.Dr Jeton Shasivari “E drejta kushtetuese” Shkup 2020 faqe316

4 5 Kushtetuta e vitit 1991 inauguron vetëqeverisje lokale në shkallë të parë. Qyteti i Shkupit është i përcaktuar si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, ku organizimi i saj rregullohet me ligj. Gjithashtu, Kushtetuta lejon themelimin e formave të ndryshme të vetëqeverisjes vendore. Me metodën e enumeracionit pozitiv parimor, Kushtetuta i përcakton fushat themelore që përfshihen në kompetencat komunale, duke i garantuar edhe burime të të ardhurave personale, si edhe mjete republikane për realizimin e tyre. Kuptohet, kompetenca e përcaktuar kushtetuese nuk është përfundimtare, por mund të plotësohet me ligj. Bëhet fjalë për të ashtuquajturat kompetenca burimore në kryerjen e të cilëve komuna gëzon pavarësi, ndërsa mbikqyrja shtetërore shtrihet nën ligjëshmërinë e punës. Koncepti kushtetues i vetëqeverisjes lokale e thekson demokracinë direkte në procesin e vendosjes në nivel lokal (kombinim i formave të demokracisë direkte dhe përfaqësuese). Rëndësia e veçantë e vetëqeverisjes lokale për demokracinë maqedonase del nga imperativi kushtetues, normat kushtetuese për vetëqeverisjen lokale që operacionalizohen me sistem ligjor për vetëqeverisje lokale që sillen me dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve , me çka në frymën e Marrëveshjen kornizë nga viti 2001 dhe amandamenti i XVI i kushtetutës së RM, është e nevojshme edhe shumica e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët i përkasin bashkësisë e cila nuk paraqet shumicë në RM. Procedura e tillë etnike e veçantë zbatohet edhe gjatë sjelljes së ligjeve për financimin lokal, zgjedhjet lokale , kufijtë e komunave dhe për qytetin e Shkupit .⁸

⁸ Prof.Dr Jeton Shasivari “E drejta kushtetuese” Shkup 2020 faqe 317

1.3 Koncepti ligjor I qeverisjes lokale në RMV

Ligji aktual për qeverisjen lokale është miratuar nga kuvendi I RMV-së me 24 januar të v.2002 Mirëpo përgaditja e tij ka filluar qysh në v.1998 me inkorporimin për her të parë të ministries së qeverisjes lokale.

Me këtë ligj regullohen :kompetencat e komunës,pjesmarja e drejtëpërdrejtë e qytetarëve në marjen e vendimeve,organizimi dhe puna e organeve të komunës,administrat komunale,aktet e organeve,prona e komunës,mbykqyrja e organeve mbi punën e organeve të komunës,shpërndarja e këshillit të komunës,mekanizmat e bashkpuinimit ndermjet komunave dhe qeveris së republikës,qeverisja vendore,mbrojtja e qeverisjes lokale,përcaktimi I gjuhëve zyrtare në komuna dhe qështje tjera me rëndesi për qeverisjen lokale.⁹

Nga ana tjetër dominimi I kompetencave dhe I fuqisë së kryetarëve të komunës në strukturën e kompetencave të qeverisjes lokale si dhe në qasjen e resurseve të tij,ndikojnë paraqitjen dhe perforcimin e një modeli të vërtetë të monopolit monokratik të pushtetit dhe të fuqisë në udhheqjen e politikave lokale dhe në shfrytëzimin e resurseve publike të bashksive lokale.

Në periudhën kohore deri në vitin 2005 sot edhe më tepër pothuajse kompetencat dhe fuqija e qeverisjes locale në RMV po perqëndrohen në pensionin e kryetarit të komunës.

Prefekti përveq asaj që është funksionari I vërtetë egzekutivo-administrativ,ai mer pjesë edhe në funksionin normativ (ligjdhënës) të bashksis lokale në atë menyre që është propozues I autorizuar I vendimeve të këshillit të asaj bashkesije.

Ai udhheq me shërbimet profesionale dhe administratën e njësis së qeverisjes lokale.

Të punësuarit në ato organe drejtëpërsëdrejti dhe ne menyr të plotë varen nga prefekti ai vendos për të drejtat e personave juridikë dhe fizikë në nprocedurën administrative.

Prefekti I emëron dhe shkarkon drejtorët dhe organet e qeverisjes lokale.

Ai e siguron shfrytëzimin dhe mbrojtjen e pronës së qeverisjes lokale.

Prefekti është ekskluzivishtë competent për mbarimin egzekutimin e vendimeve të këshillit.

Ai është competent edhe për mbarimin e buxhetit të njësis së qeverisjes lokale duke pasur competence të plotë mbi politikën e përmbaruesit dhe udhheqjes me punët e qeverisjes lokale.

Nga ana tjetër prefekti me asgje nuk varet nga keshilli I njësis së qeverisjes lokale poashtu nuk

⁹ Prof.Dr Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" Shkup 2020 faqe 317

mvaret me asgjë edhe nga qytetarët mbase për atë nuk është parapar as impicmenti e as revokimi.

Pra për deri sa është gjallë dhe shendosh e mire dhe për deri sa në kuptimin formal-juridik u përmbahet ligjeve që është lehtë për tu realizuar.

Atë askush nuk mund të ndërroj pa mar parasysh se aim und ta humbë autoritetin dhe legjitimitetin e funksionarit publik (funksionarit që është në shërbim të interesave publike të qytetarëve dhe popullsis lokale).

Perball një pozicioni të tillë të prefektit,këshilli I njësis së qeverisjes lokale ka një pozicion ndjeshem më të dobët.

Këshilli miraton akte dhe vendime duke rregulluar disa lemi dhe qështje në menyr të përgjithshme me qka e normon kornizen e politikave lokale.

Kuptohet se kjo gjë paraqet një dimension mjaft të rëndësishem për jetën dhe interesat ebashkësis lokale dhe për funksionimin e qeverisjes lokale mirëpo determinimi I pare dhe kryesor I atyre akteve dhe vendimeve është propozimi I tyre pra përkufizimi I dispozitivit të vendimëve të argumentacionit dhe rrezultatet e përbarimit të tyre.Krejt këtë e përgadit dhe e siguron shërbimi professional dhe administrate e qeverisjes lokale nderkaq e verifikon propozon dhe realizon prefekti.¹⁰

Pra selektimi I mundshëm I prioriteteve dhe I argumenteve ndodhet në pushtetin dhe fuqinë e prefektit.

Në këtë drejtim është e mundshme edhe konsekuenca e krejt kësaj situate që konsiston në selektimin e interesave duke mos i përfillur interesat e përgjithshme dhe të përbashketa të bashkësis lokale dhe të qytetarëve një gjë e tillë është më së reale.

Në kushte kur dominojn interesat e veqanta partiake,kriminale apo të grupeve të biznesit që paraqitën si një realitet në numër të madh të rasteve mbrenda për mbrenda eksperiencës së këty modeli të qeverisjes lokale në RMV. Ne menyrë plotëesuese mozaikui tillë rrumbullaksohet në faktin se vetë qytetarët janë subjekti më I dobët në konceptin e vetadministrimit lokal në RMV. Qytetarët pas aktit të zgjedhjeve locale nuk kanë kurfar pozicioni apo qasje në praktikën e vetadmionistrimit lokal.

¹⁰ Prof.Dr Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" Shkup 2020 faqe 318

Institutet e demokracisë së drejperdrejt siq janë:

Iniciativat dhe tubimet e qytetarëve janë modele tepër të dobëta për rolin e qytetarëve në vet adiminstimin lokal në RMV.

Këto mekanizma janë difuze,shum rëndë vihen në levizje dhe si një kapak I ksaj,krejt ajo që mund të del si konkluz e tyre,nuk I detyron organet e vet administrimit lokal.

Pra gjdo përpjekje e qytetarisë lokale mvaret nga konstatimi dhe vullneti I prefektit dhe keshillit të komunës.

Krejt ky domen I participimit të qytetarëve në vet administrimin local paraqet një domen që ri I varur në ajër,pa mekanizma të duhura për ndikimin efektiv ndaj organeve të vetadministrimit lokal.

Deri në vitin 2002 deri në ligjin e ri për vetë administrimin local,qytetarët kishin mundësi që të votojnë lidhur me votëbesimin e prefektit të cilin vet e kanë zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta.

Ky instrument paraqiste një mundësi për të provuar legjitimitetin e prefektit si dhe për të sendërtuar verifikimin demokratik të punës së ty nga aspekti I interesave të popullsis lokale.

Mirepo ky instrument u abrogu me ligjin actual të vitit 2002,kështu që sot normativisht dhe praktikisht është në fuqi pozicioni I paprekshëm I prefektit.

Në pozicionin e qytetarëve ka ngelur ende referendumi me të cilin mundë të ndikohet në organet e vetadministrimit lokal për një qeshtje të caktuar.

Edhe për kundër preferimit të ti si një praktik dhe politik e pergjithshme evropjane (sipas kartës evropjane për vetqeverisje lokale)referendumi lokal nuke arriti të nikoqirezohet në vetadministrimin local të RMV.

Referendumi lokal nuk e zbatojn edhe partit politike në kuader të politikës së tyre locale,gjë që flet mjaft për preferimin e rolit partiak për para rolit të qytetarëve në kuader të politikave lokale,gjë që paraqet edhe një indicator për disa dukuri tjera.¹¹

¹¹ Prof.Dr Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" Shkup 2020 faqe 319

1.4 Qeverisja lokale në RMV pas marveshjes kornizë te Ohrit

Pas nënshkrimit të marveshjes kornizë të Ohrit me 13.08.2001 si dhe pas miratimit të amendamenteve kushtetuese në bazë të saj, me anë të pakos ligjore të miratuar në vitin 2002 dhe vitin 2004, vet administrimi lokal në RMV përrjetoj ndryshime të rëndesishme në pjesën reth kompetencave dhe financimit të tij.

Por me keto ligje nuk u prek tipi dhe shkalla e vet administrimit lokal ne RMV.

Reforma e përfshirë me anë të ketyre ligjeve qenesisht I zmadhoji kompetencat e vet administrimit local në RMV dhe e perforocoji sistemin e financimit të tij.

Lista e kompetencave përfshin 12 lemi në të cilat parashihen funksione dhe detyra të shum numërta dhe komplekse të vet administrimit lokal.

Regjisti I kompetencave përnjëher u bë aq I madh dhe aq I zgjeruar sa që veshtruar krahasimtarisht mund të thuhet se vetadministrimi local I RMV sipas të gjitha gjasave,ka kompetenca më të mëdha në Evrop.

Ky fakt vetvetiu flet për konstrukcionin e lemit të kompetencave që është bërë më tepër në aspektin teknin se sa në atë praktik.

Për këtë gjë flet,hapi I madh që është bërë reth një pozicioni të tillë,përkatësisht nga pozicioni I një vetadministrimi lokal më të dobët dhe më inkopetent në Evrop.

Është më se evident fakti se modeli I kompetencave nuk është derivuar në një formë analitike nga gjendja faktike dhe nga aftesija reale e njësive të vetadministrimit lokal dhe të institucioneve të tij në RMV.¹²

Dallimet ndermjet njesive të vet administrimit lokal si dhe dallimet në aftesit e tyre, burojnë si nga fakti I mungesës së pajisjeve dhe ndërtimit të tyre në aspektin e përgjithshem institucional teknik dhe kadrovik,poashtu edhe nga fakti I mungesës së trajnimit të duhur dhe të pervojeës në ushtrimin e funksioneve profesionale dhe administrative në më tepër lemi që iu lane dorë vetadministrimit lokal.

Në këtë drejtim,mjafton që ta kemi parasysh faktin se ndermjet njesive të vetë administrimit lokal egzistojn dallime të atilla që nuk hasën në ndonjë vend tjetër kur dihet parasysh fakti se në RMV regjistri I kompetencave është I njejtë si për qytetin e Shkupit,ashtu edhe për komunat e

¹² Prof.Dr Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" Shkup 2020 faqe 320

tjera të themi,të Zernovcit Manastirit,Bogovinës,apo Vraneshtices ose është thënë ndryshe ai është I njejtë edhe për komunat me përvoj të pasur administrative,institucionale,kadrovike dhe material – teknike, edhe për komunat popullsija lokale etë cilave nuk ka as edhe 10 deri 15 persona me arsimim sipëror dhe që skanë përvojën e duhur në qeverisjen me punët publike.

Kur flitet për tipin dhe për shkallen vetadministratimit lokal në RMV –së , mund të thuhet se ai edhe pas vitit 2005 ngeli ashtu qfar ishte pra,edhe më tej kemi modelin e vet administrimit lokal monotipik dhe një shkallësh.

Është e sigurt se me kalimin e kohes do të riaktualizohet qeshtja e vetadministimit lokal dy shkallësh.

Gjatë kësaj do të bien posht të gjitha paragjykimet negative të nderlidhur me segmentimin dhe seperacionin etno-politik,sepse dote kuptohet se këto procese nuk kanë lidhje me vetadministrimin lokal dhe as që burojn prej ti.

Vetadministrimi lokal dy shkallësh në RMV-së mund të jetë një faktor pozitiv në jetën e popullsis lokale por, vetëm me kusht nëse ajo nuk I përsërit gabimet në të kaluerën lidhur me rrethet e sistemit të kaluar të vetadministrimit lokal.¹³

¹³ Prof.Dr Jeton Shasivari “E drejta kushtetuese” Shkup 2020 faqe 321

1.5 Organizimi territorial I qeverisjes lokale në RMV

Me ligjin për organizimin territorial të vetë administrimit lokal në RMV –së të dt 11.08.2004 u themeluan gjithsej 84 komuna.

Me këtë gjë njesit e vetadministrimit lokal u bënë ende më të mëdha.


Kështu që madhësija mesatare e komunës u zmadhua nga 209 km katror në vitin 1996,në 306 km katror,nderkaq tani numri mesatar I popullsis nël komunë arriti në 25000 përkundër 16.352 banorëve në periudhen 1996-2004.

Në këtë menyrë,RMV hini në mesin e shteteve me komuna më të mëdham,në të cilat më tëpër gjasa ka që të zhvillohet vetadministrimi lokal I tipit përfaqesuse se sa ai I tipit të drejtprdrejt.

Qeveria e asaj kohe, këtë zmadhim të komunës e arsyetonte me zmadhimin e kompetencave dhe financave të tyre si dhe ,meqëllimin esaj që të krijoj komuna që do të jenë të afta të përballën me zhvillimin e bashkësis lokale.

Mirëpo,analizat konkrete të këtyre zgjidhjeve të qeveris,megjithatë e kundërshtojnë qëndrimin e saj,për arsye se rezultati përfundimtar flet për atë se qeveris I doli nga kontrolli realizimi I këty qëllimi dhe në vend tël tij dolën në pah momente tjera edhe ate:

Interesat partiake,efektet lobuese dhe stereotipet krahinore të një pjeëse e pushtetarëve të atershëm qëndror.¹⁴



¹⁴ Prof.Dr Jeton Shasivari "E drejta kushtetuese" Shkup 2020 faqe faqe 322

Mbi këto baza edhe u krijuan ndarja territoriale që nuk flet për një politik konsistente të pushtetit egzekutiv.

Thënë më konkretisht me këtë lig:u ruajt komuna e Zernovcit me tri fshatra të cilët aspak nuk formojnë ndonjë tërësi lokale,u ruajt komunat e paaft dhe dobët e zhvilluar e Zelenikovës,pasensin e duhur,u bashkuan komunat e Beliçicës dhe Mesheishtës,të cilat përbëjnë një tërësi lokale krejtisht të ndryshme dhe asnjher nuk kanë gravituar njëra me tjetrën.

Komunës së Tetovës dhe komunës së Gostivarit iu bashkangjiten ish komunat e Gjepçishtit dhe Banjices së poshtme të cilat në ndarjen paraprake,dëshmuar se ne sukses mund të përballën me zhvillimin e bashkësis lokale.

Zmadhimi I komunave për arsye të zmadhimit të kompetencave të tyre,është e arsyeshme nëse ajo realizohet në suaza të komunave të të njejtit lloj. Se kjo nuk ka qenë qëllim I qeveris flasin faktet në vijim,në vend që ish-komunat e Banjiçes,Serbinoves dhe Vrtokit,të bashkohën në një komun të madhe unike e rurale me seli në Banjice,të gjitha këto bashkohën me komunën e Gostivarit.

Në vend që komunat e Bistrices dhe Baçit të bashkohën në një tërësi lokale ato bashkohen me komunën e Manastirit.

Në komunën e Bistricës jetonin mbi 20% shqiptarë kurse komuna aktuale e Manastirit ka vetëm 4-5%shqiptar.

Komuna e Gjepçishtit që ishte një komunë e madhe edhe sipas sipërfaqës edhe sipas numrit të banorëve,në vend që të ngelte edhe më tutje si komunë e veçantë, ajo iu bashkua komunës së Tetovës.

Në krahasim me vendet fqinje dhe disa shtete evropiane me demokraci të zhvilluar, organizimi territorial dhe ndarja administrative në njësi të qeverisjes lokale në Maqedonisë është tepër e centralizuar, që vërehet nga vetë niveli i këtij organizimi, vetëm në një nivel ndarës mes pushtetit qendror dhe lokal, pushtet qendror-komuna, ndërsa në vendet tjera kjo ndarje kalon përmes disa niveleve të ndarjes së pushtetit lokal nga ai qendror, së paku në 3, 4 dhe 5 nivele, siç është theksuar në vazhdim të kësaj analize, përmes përvojave të shteteve të tjera në lidhje

me organizimin territorial dhe ndarjen administrative të këtyre shteteve. Aktualisht, përveç komunave si njësi të qeverisjes lokale, Maqedonia në aspektin administrativ është e ndarë edhe në 8 rajone për planifikim rajonal, por ato nuk kanë status të njësive të veçanta administrative, dhe si të tilla nuk janë funksionale, meqë janë krijuar vetëm si rajone për planifikimin kinse më efikas të zhvillimit ekonomik të vendit. Me ndryshimin e këtij ligji dhe pakos së ligjeve për organizimin territorial dhe ndarjen administrative të njësive të qeverisjes lokale, me të cilat rregullohet kjo çështje në Maqedoni, do të përcaktohet më drejtë dhe më qartë organizimi territorial i këtyre njësive të qeverisjes lokale, **komunave, qyteteve dhe rretheve**, përkatësisht **rajoneve administrative autonome**, duke pasur parasysh dështimet e derisotme në ndarjen administrative të shtetit, në interes të zhvillimit kinse më efikas ekonomik të rajoneve të shtetit. Sipas gjendjes së tanishme, me ndarje të panatyrshme, ku vendbanime të një komune i kalojnë kufijtë e një komune tjetër fqinje, për t'iu bashkëngjitur një ose disa vendbanime të një komune tjetër, në bazë të parimit etnik, i cili këtë ndarje e bën të panatyrshme dhe jofunksionale. Me organizimin e ri territorial dhe ndarjen e re administrative, përmes ndryshimit të ligjit ekzistues, përveç komunave dhe qytetit të Shkupit (me 10 komuna në kuadër të tij), do të ishte tepër e dobishme dhe funksionale të bëhet ndarja e re territoriale e Maqedonisë edhe në njësi më të mëdha administrative, në nivel të Rretheve, përkatësisht rajoneve administrative autonome. Sipas propozimit tonë, i cili mund të pasohet edhe me ide të reja, ndryshime dhe plotësime nga ekspertë të kësaj fushe dhe nga organet kompetente të pushtetit, riorganizimi territorial i Maqedonisë, përveç komunave ekzistuese dhe qytetit të Shkupit duhet të përfshijë edhe njësi më të mëdha administrative, rrethe ose qarqe, me disa qytete dhe komuna të një rajoni me karakteristika të ngjashme gjeografike, historike, ekonomike, kulturore, sociale dhe të tjera, siç janë paraqitur në vazhdim:

1. **Rrethi i Tetovës**, me qytetet: Tetovë dhe Gostivar (me Mavrovën);
2. **Rrethi i Ohrit**, me qytetet: Ohër, Strugë, Dibër, Kërçovë, Brodi i Maqedonisë, Krushevë, Demir Hisar dhe Resnjë;
3. **Rrethi i Manastirit**, me qytetet: Manastir, Prilep dhe Veles (Qupërli);

4. **Rrethi i Shkupit**, me qytetet: Shkup dhe Kumanovë, me komunat e tyre përreth;
5. **Rrethi Shtipit**, me qytetet: Shtip, Pallankë, Kratovë, Probishtip, Shën Nikollë, Koçanë, Kamenicë, Dellçevë dhe Vinicë;
6. **Rrethi i Strumicës**, me qytetet: Strumicë, Berovë, Radovish, Gjevgjeli, Kavadar, Negotinë dhe Dojran.

Në pakon e këtyre ndryshimeve të domosdoshme ligjore mund të shqyrtohen edhe modele të tjera për organizimin territorial dhe ndarjen administrative sipas modelit të propozuar më lartë, edhe atë, mund të shqyrtohet mundësi e bashkimit të dy rretheve të propozuara në rrethe më të mëdha, kështu që, i tërë territori i Maqedonisë do të ndahej në tri njësi të veçanta administrative, ku nga gjashtë rrethet e propozuara do të formoheshin tri rrethe, me atë që: Rrethi i Shkupit dhe Rrethi i Tetovës do ta përbënin një Rreth të veçantë, Rrethi i Manastirit dhe Rrethi i Ohrit do ta përbënin rrethin e dytë, ndërsa Rrethi i Prilepit dhe Rrethi i Strumicës do ta përbënin rrethin e tretë. Me këtë rast, ua përkujtojmë të gjithë faktorëve vendimmarrës në vend se kjo ide nuk paraqet diçka të re në formën e organizimit territorial dhe ndarjen administrative të shtetit, por mbështetet në traditën e mëhershme të Republikës së Maqedonisë, e cila me disa ndryshime minimale ka funksionuar nga viti 1957 deri në vitin 1965, kur ish republika socialiste jugosllave e Maqedonisë ka qenë e ndarë administrativisht në 4 rrethe, përkatësisht në katër rajone kryesore të Maqedonisë. Përmes këtij organizimi të ri territorial të Republikës së Maqedonisë do të tejkalohen të gjitha tendencat për ndarjen politike-territoriale të shtetit, si idetë për organizimin e vendit në formë federate ose konfederate, të cilat aktualisht janë tema tepër të ndjeshme për opinionin e brendshëm, duke marrë parasysh mundësinë e riorganizimit më efikas territorial dhe ndarjen administrative të shtetit në njësi më të mëdha dhe më funksionale, në nivel të rretheve, përkatësisht të rajoneve autonome, të cilat do të funksionojnë në formë identike si kantonet në disa shtete evropiane, siç paraqiten në këtë analizë.¹⁵ Me këtë ndarje do të sigurohet zhvillim i barabartë ekonomik i të gjitha rajoneve të vendit, ndarje e drejtë dhe proporcionale e buxhetit, zbatim më i plotë i përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në nivel lokal, rajonal dhe në nivel shtetëror, si dhe

¹⁵ Elida Zylbeari 23-01-2017

do të rregullohen shumë çështjeve të tjera, të cilat në mënyrë të veçantë kanë të bëjnë me barazinë dhe të drejtat e popullit shqiptar në Maqedoni.

Komunat në RMV

[Aerodrom](#) [Haraçinë](#) [Berovë](#) [Manastir](#) [Bogdanci](#) [Bogovinë](#) [Bosilovë](#)

[Brvenicë](#) [Butel](#) [Valandovë](#) [Vasilevë](#) [Vevčan](#) [Veles](#) [Vinicë](#)

[Vrapçisht](#) [GaziBabë](#) [Gjevgjeli](#) [GjorçePetrov](#) [Gostivar](#) [Dibër](#) [Debarcë](#)

[Delçevë](#) [DemirKapi](#) [Demir Hisar](#) [Dojran](#) [DolnenZhelinë](#) [Zelenikovë](#) [Zrnovc](#)

[Ilinden](#) [Jegunovcë](#) [Kavadarc](#) [Karbinc](#) [Karposh](#) [KiselaVodë](#) [Kërçovë](#)

[Konçe](#) [Koçan](#) [Kratovë](#) [KrivaPalankë](#) [Krivogashtan](#) [Krushevë](#) [Kumanovë](#)

[Likovë](#) [Lozovë](#) [MavrovëdheRostushë](#) [MakedonskaKamenicë](#) [MakedonskiBrod](#)

[Mogillë](#) [Negotinë](#) [Pehçevë](#) [Novac](#) [Novo Sellë](#) [Ohër](#) [Petrovec](#)

[Plasnicë](#) [Prilep](#) [Probishtip](#) [Radovish](#) [Rankovcë](#) [Resnjë](#) [Rosoman](#)

[Saraj](#) [SvetiNikollë](#) [Shkup](#) [Sopishtë](#) [StaroNagoriçan](#) [Strugë](#) [Strumicë](#)

[Studenica](#) [Tearcë](#) [Tetovë](#) [Centar Zhupa](#) [Çair](#) [Çashka](#) [Çeshinovë](#)

[Çuçer Sandevë](#) [Shtip](#) [Qendër](#) [Shuto Orizare](#)¹⁶

¹⁶ Ministria e Qeverisjes lokale 28-11-2020

1.6 Procesi I decentralizimit të kompetencave të qeverisjes lokale në RMV

Decentralizimi, gjatë viteve të fundit, gjendet në qendrën e jetës politike dhe administrative në Maqedoni.

Më herët, pas vijimit të pavarësisë së shtetit më 1991, autoritetet kanë miratuar një strategji për centralizimin e pushtetit me qëllim të përforcimit të kontrollit të tyre mbi territorin. Kjo strategji ka qenë e ndryshuar pas konfliktit më 2001 dhe me Marrëveshjen e Ohrit. Për të siguruar ndarje më të mirë të pushtetit lokal mes komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Maqedoni, marrëveshja e Ohrit kërkonte një reformë të decentralizimit të pushtetit. Kjo reformë, e mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe nga aktorët kryesor ndërkombëtar në Maqedoni, kanë zbatuar ndryshime të mëdha legjislative në vitin 2004. Territori i Maqedonisë për momentin është ndarën 84 komuna (me qytetin e Shkupit, që përbëhet nga 10 komuna). Këto komuna kanë më tepër pushtet se më parë, gjatë vendimmarrjes dhe gjatë shpërndarjes së buxhetit. Komunat kanë fuqi më të mëdha dhe të rritura në lidhje me zhvillimin e ekonomik lokal, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës, urbanizmi, kultura, sport, mbrojtja shoqërore dhe mbrojtja e fëmijëve si dhe arsimin. Zbatimi praktik i procesit të decentralizimit akoma është në rrjedhë. Transferim i kompetencave ka hasur në shumë probleme për shkak të procesit të ndërlikuar por edhe nga situata e transicionit politik dhe ekonomik që ndodh në Maqedoni. Në krye të secilës komunë, gjendet kryetari i saj dhe këshilltarët të zgjedhur në zgjedhje direkt të përgjithshme. Komunat financohen nga burimet vetjake, nga tatimet e të ardhurave, si dhe nga donacionet që rrjedhin nga buxheti nacional. Për të siguruar ndarje më të mirë të pushtetit mes komunave etnike, disa vendimmarrje në nivel komunal votohen me parimin e « Badinter », sipas emrit të ish ministrit francez Robert Badinter. Ky parim nënkupton që votimin për çështjet duhet të përmban shumicën e votave të dy grupeve : ata të shumicës së këshilltarëve komunale dhe shumicën e këshilltarëve që përfaqësojnë komunitetet etnike të pakicave në komunë.

Siç dihet procesi i decentralizimit në Maqedoni zbatohet nga koriku i vitit 2005-të kur edhe filloi faza e parë e transferimit të kompetencave. Ndërsa, duke filluar nga pluralizmi dhe deri në zgjedhjet e para lokale në vitin 1996-të, qeveria me akte normative centralizoi pushtetin në skajshmëri.

Ky proces aktualisht zbatohet në bazë të rregullativës ligjore pozitive të vendit edhe atë konform Ligjit për vetëqeverisje lokale ,Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjeve lokale dhe ligjeve tjera materiale ku parashihen kompetenca për komunat.Në aspektin fiskal, edhe pse përqindja e Tatimit të Vlerës së Shtuar që ju alokohet pushteteve vendore është ritur nga 3% deri më 4,5% (përqindje e përgjithshme e akumuluar),përsëri shumë ekspert vendorë dhe të jashtëm me të drejtë konstatojnë se vendi akoma është më i centralizuar në Evropë në aspektin fiskal. Në aspektin politik në Maqedoni ende nuk mbizotëron vullneti i mjaftueshëm për një decentralizim më të mirfilltë,sidomos në kuadrin fiskal, për ritjen e përqindjes së TVSH-së (për komunat) ,përqindjes së tatimit personal ,siç është në shtetet fqinje dhe më gjërë. Madje ritjen e bllok dotacioneve, dotacioneve të destinuara,transferin e kompetencave në sferën sociale (për fillim procedurat administrative të përgjithëshme) etj.Në sferën e urbanizmit dhe planifikimit hapsinor komunat në Maqedoni edhe pse për disa procedura monitorohen nga pushteti qendror (përveç mbykqyrjes exoficio),duke qenë të obliguar të kërkojnë mendimin apo pëlqimin e tyre. Në këte fushë edhe pse në aspektin sasior kompetecat janë të mjaftueshme,mirëpo pa kapacitete buxhetore edhe këta as për së afërmi nuk mund të implementohen në praktikë. Si do që të jetë, në Maqedoni mbetet të shihet se transferimi i të drejtës që pushtetet lokale të menaxhojnë me tokën ndërtimore në pronësi shtetërore , sipas modelit të paraparë me Ligjin për tokën ndërtimore ,a do të jetë model që do të ndikoj në zhvillimin ekonomik lokal, apo sipas asaj që konstatojnë ekspertët dhe opinioni, mënyra direkte e tjetërsimit të aseteve të palujtëshme vendore është e gabueshme kur kihet parasysh se më së paku është praktikuar në shtetet e Evropës juglindore. Kur jemi të zhvillimi ekonomik lokal ,duhet theksuar faktin se në vendë nuk zbatohet me përpikmëri edhe Ligji për zhvillim të barabartë ekonomik rajonal,aq më tepër kur edhe 1% i bruto prodhimit vendor i paraparë me ligj nuk shpërndahet saktësishtë. Ky ligj parasheh komisione të shumta e që në vehte paraqet byrokraci, aq më tepër kur kjo përqindje as për së afërmi nuk mund të ndikoj në zhvillimin ekonomik rajonal e lëre më zhvillim të barabartë. Egziston mosgadishmëri e qeverive që me seriozitetin më të madh tu kthehen edhe njëherë ligjeve që tangojnë decentralizimin , për ti reformatuar ato ,për një proces më të prekshëm për shërbimet që u garantohen qytetarëve dhe pse jo edhe për një demokraci lokale solide.

Nuk ka kohë për të humbur, aq më tepër kur vendi duke u bazuar në situatën aktuale politike ,ekonomike, sociale ka nevojë për një rikonsolidim juridiko-politik dhe në këtë kuadër decentralizimi të trajtohet në mënyre meritore konform frymës së Marëveshtjes së Ohrit dhe Kartës Evropiane për vetëqeverisje lokale të cilën Maqedonia e ka të ratifikuar. Me që zhvillimi i këtij procesi po ecë me hapa të breshkës ,andaj me të drejtë shtrohet dilema se në Maqedoni ka decentralizim apo dekoncentrim të pushtetit. Mbase edhe në shumë konferenca rajonale decentralizimi trajtohet si mundësi apo sfidë për ekonominë dhe demokracinë.¹⁷¹⁸

¹⁷ <http://bn-mk.org/sq/content/decentralizimi-n%C3%AB-maqedoni.html> 28-11-2020

¹⁸ Redaksia Portalb 24-04-2015

KAPITULLI I DYTË

KOMPETENCAT KOMUNALE, ORGANET E QEVERISJES LOKALE DHE DEMOKRACIA LOKALE

NË RMV

2.1 Kompetencat komunale të qeverisjes lokale në RMV

Ligji për vetëqeverisje lokale me kompetencë nënkupton “ përmbledhje të punëve me interes publik dhe me rëndësi lokale të cilët komuna , në pajtim me ligjin , ka të drejtë t’i kryejë në territorin e saj dhe është përgjegjëse për kryerjen e tyre”(neni 2 paragrafi 1 pika 6 nga LVL). Gjatë përcaktimit të “kompetencave të përgjithshme” ligjdhënësi nisët nga parimi i subsidiaritetit, sipas të cilit “ komunat kanë të drejtë në territorin e tyre t’i kryejnë punët me interes publik të rëndësisë lokale, që nuk janë të përjashtuara nga kompetenca e tyre ose nuk janë në kompetencat e organeve të pushtetit shtetëror”(neni 20 nga LVL). Në frymën e Konventës Evropiane për vetëqeverisje lokale, Ligji vërteton tri parime themelore të lidhura me kompetencat e komunave. Sipas parimit të parë, komunat janë të pavarura në rregullimin dhe kryerjen e punëve me interes publik të rëndësisë lokale, të përcaktuara me Ligj dhe janë përgjegjëse për kryerjen e tyre. Sipas parimit të dytë, gjatë përcaktimit ligjor të kompetencave të tjera përcaktohen edhe burimet për financimin e tyre. Sipas parimit të tretë, kompetencat e komunave të përcaktuara me ligj me të drejtë janë të tërësishme dhe me përjashtime dhe nuk guxojnë të merren ose kufizohen, përveç në rastet caktuara me ligj (neni 21 nga LVL). Ligji për vetëqeverisje lokale përmban listë të gjatë dhe detale të kompetencave burimore:

Planifikimi urbanistik;

Mbrojtja e ambientit jetësor dhe natyror;

Zhvillimi ekonomik lokal, veprimet komunale;

Kultura ;

Sporti dhe rekreacioni;

Mbrojtja sociale dhe mbrojtaje e fëmijëve;

Arsimi;

Sigurimi primar shëndetësor;

Zbatimi i përgatitjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet luftarake, fatkeqësive të ndryshme natyrore

Mbrojtja kundër zjarrit;

Mbikqyrja në kryerjen e punëve të kompetencave të tyre dhe punë të tjera të parapara me ligj. Edhe pse LVL nuk bën klasifikime në kompetenca të domosdoshme dhe fakultative, në nenin 21 paragrafi 3 thuhet se :” Me ligj përcaktohen të gjitha punët që janë në kompetencë të komunave të cilët ajo domosdo do t’i kryejë’. Përveç kompetencave të ashtuquajtura burimore dhe të pavarura,, LVL parimisht e operacionalizon dispozitën kushtetuese për kompetencë të deleguar. Së pari, punohët për delegim të kryerjes së punëve të caktuara nga organet e administratës shtetërore të kryetarit të bashkisë në pajtim me ligjin. Së dyti, delegimi i kompetencave duhet të jetë i përcjellë me transferimin e mjeteve financiare për kryerjen e tyre. Së treti, në suazat e standardeve të paracaktuara me ligj, egzekutimi i kompetencave të deleguara komuna mund t’i përshtasë me kushtet lokale. Dhe, së terri organi i administratës shtetërore është përgjegjës për kryerjen e punëve të deleguara. Në kryerjen e punëve të kompetencave të saj, komunat mund të themelojnë shërbime publike në pajtim me ligjin. Gjithashtu, përcaktohet mundësia për kryerjen e punëve të deleguara nga kompetenca komunale në persona juridikë dhe fizikë, në bazë kontratës të përbashkët për kryerjen e punëve nga interesi publik, në pajtim me ligjin. Kuptohet, komuna mbetet përgjegjëse për punën të cilin ekzekutiva ia delegon.¹⁹

Komunat në mënyrë të pavarur, në suaza të ligjit, i regullojnë dhe kryejnë punët e interesit publik me rëndësi lokale, të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër dhe janë përgjegjëse për

¹⁹ Vetqeverisja lokale në RMV (Zemri Elezi ligjërata e IV)

kryerjen e tyre. Me ligjin me të cilin rregullohen kompetencat e tjera të komunave caktohen edhe burimet financiare për kryerjen e atyre kompetencave. Kompetencat nga paragrafi (1) të këtij neni parimisht janë të plota dhe të pakontestueshme dhe nuk guxojnë të merren ose kufizohen, përveç në raste të përcaktuara me ligj.

Lista e kompetencave

(1) Komunitat janë kompetente për kryerjen e punëve vijuese:

1. Planifikimi urbanistik (urban dhe rural) , dhënia e lejes për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimi i hapsirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore.

2. Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës - masa për mbrojtje dhe pengimin nga ndotja e ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurmimi dhe rrezatimi jonizues.

3 Zhvillimi ekonomik lokal- planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal ; përcaktimi i përparësive zhvillimore dhe strukturale, udhëheqja me politikën ekonomike ; përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të iniciativave në nivel lokal dhe në atë kontekst pjesëmarrja në vendosjen dhe zhvillimin e rrjetit lokal të institucioneve dhe agjensive dhe promovimi i partneritetit;

4. Veprimtaritë komunale -furnizimi me ujë për pije; përcjellja e ujit teknologjik; përcjellja dhe pastrimi i ujrave të ndotura; ndriçimi publik; dërgimi dhe trajtimi i ujrave atmosferik; mirëmbajtja e higjienës publike; grumbullimi, transportimi dhe procedimi me mbeturinat e ngurta komunale; rregullimi dhe organizimi i trafikut publik lokal të udhëtarëve; furnizimi me gaz natyror dhe energji ngrohëse; mirëmbajtja e varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhënia e shërbimeve mortërore; ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale, rrugëve dhe objekteve të tjera të infrastrukturës; rregullimi i regjimit të komunikacionit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimeve rrugore të komunikacionit, ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirës publike të parkimit; mënjanimi i automjeteve të parkuara gabimisht; mënjanimi i automjeteve të dëmtuara nga sipërfaqet publike; ndërtimi

dhe mirëmbajtja e tregjeve; pastrimi i oxhaqeve; mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, gjelbërimit, park-pyjeve dhe sipërfaqeve rekreative; rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i shtratit të lumenjve në pjesët e urbanizuara; përcaktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës.

5. Kultura- përkrahja institucionale dhe financiare të enteve dhe projekteve kulturore; kultivimi i folklorit, zakoneve, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore; organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të llojllojshme specifike të krijimtarisë.

6. Sporti dhe rekreacioni - zhvillimi i sportit masiv dhe i aktiviteteve rekreative; organizimi i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive; mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve për sport; përkrahja lidhjeve sportive;

7. Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve- çerdhe për fëmijë dhe shtëpi të pleqve (pronësi, financim, investime dhe mirëmbajtje); realizimi i përkujdesjes sociale për persona invalidë; fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore; fëmijëve me probleme edukativo-sociale; fëmijëve me nevoja të veçanta; fëmijëve nga familjet njëprindërore; fëmijëve në rrugë; personave të ekspozuar rrezikut social; personave të prekur nga keqpërdorimi i drogës dhe alkoolit; ngritja e vetëdijes së popullatës; strehimi i personave të rrezikuar social; realizimi i së drejtës dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore. Kryerja e këtyre kompetencave është në pajtueshmëri me Programin Nacional për zhvillim të mbrojtjes sociale;

8. Arsimi- themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror, në pajtueshmëri me ligjin, organizimi i transportit dhe ushqimit të nxënësve dhe vendosjen e tyre në konvikte nxënësish;

9. Mbrojtja shëndetësore –të drejtuarit me rrjetin e organizatave publike shëndetsore dhe me objektet nga mbrojtja shëndetësore primare të cilët duhet ta përfshijnë përfaqsimin e vetëqeverisjes lokale në të gjitha këshillat të të gjitha organizatave në pronësi publike,

edukata shëndetësore; përparimi i shëndetit; aktivitete preventive; mbrojtja e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtja gjatë punës; mbikqyrja shëndetësore mbi mjedisin jetësor; mbikqyrja mbi sëmundjet ngjitëse; ndihmë pacientëve me nevoja speciale (për shembull, shëndeti mental, keqpërdorimi i fëmijëve etj.) dhe lëmenj të tjerë që do të përcaktohen me ligj;

10. Zbatimi i përgatitjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe nga pasojat e shkaktuara nga to.

11. Mbrojtja kundër zjarrit që e kryejnë njësitë territoriale kundër zjarrit;

12. Mbikqyrja mbi kryerjen e punëve nga kompetenca e sajë dhe

13. Punë të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Kompetencat nga paragrafi (1) i këtij neni, kryhen në përputhje me standardet dhe procedurat e caktuara me ligj.

(3) Me ligj përcaktohen punët në kompetencë të komunës të cilat ajo është e detyruar ti kryej.²⁰

²⁰ Ligji për vetëqeverisje lokale faqe 7,8

Kompetenca e deleguar

(1) Organet e administratës shtetërore mund t'ia delegojnë kryerjen e punëve të caktuara nga kompetencat e veta prefektit, në përputhje me ligjin.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni barten edhe mjetet e parapara në buxhetin e Republikës së Maqedonisë për kryerjen e atyre punëve.

(3) Mënyra e kryerjes së punëve nga paragrafi (1) i këtij neni mund t'iu adaptohet kushteve lokale, me respektimin e standardeve të përcaktuara me ligj.

(4) Organi i administratës shtetërore nga paragrafi (1) i këtij neni në mënyrë subsidiare është përgjegjës për kryerjen e punëve të deleguara.

Mënyra e kryerjes së kompetencave

(1) Për kryerjen e kompetencave të veta komunat mund të themelojnë veprimtari publike në përputhje me ligjin.

(2) Komuna mund t'ua delegojë kryerjen e punëve të caktuara me interes publik dhe me rëndësi lokale personave tjerë juridik ose fizik, në bazë të kontratës për kryerjen e punëve me interes publik, në përputhje me ligjin.

(3) Komuna është subsidiarisht përgjegjëse për kryerjen e punëve të interesit public nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni.²¹

²¹ Ligji për vetëqeverisje lokale faqe 8,9

2.2 Organet e qeverisjes lokale në RMV

Organet e komunës sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale janë këshilli dhe prefekti (neni 31 nga LVL).

2.2.1 Këshilli i komunës

Këshilli është trup përfaqësues i qytetarëve. E përbëjnë nenet 9-33, varësisht nga numri i banorëve të komunës. Anëtarët e këshillit zgjidhen me zgjedhje të përgjithëshme, direkte dhe të lira, me votim të fshehtë. Ato i prezantojnë qytetarët, vendosin me bindje personale dhe nuk mund të revokohen (mandat i lirë). Këshilli është kompetent për punët më të rëndësishme për zhvillimin e komunës : për sjelljen e statutit, buxhetit, llogarisë vjetore dhe dispozitave të tjera; për vërtetimin e lartësisë së burimeve të të ardhurave personale në suazat e vërtetuara ligjore; për formimin e shërbimeve publike dhe për mbikqyrjen e punës së tyre dhe llogarisë së tyre vjetore; për zgjedhjen e udhëheqësit të njësisë territoriale në Ministrinë për punë të brendshme. Këshilli nga përbërja e tij formon komisione të përkohëshme dhe të përherëshme. Punon me mbledhje, ku për mbajtjen e së cilës është e nevojshme prezenca e shumicës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Vendimet sillen me shumicë votash nga pjesëmarrësit (shumicë relative), në rast se me Ligjin ose me statutin nuk është e rregulluar ndryshe. Me të drejtë votohet publikisht. Kur bëhet fjalë për dispozita nga kultura, përdorimi i gjuhëve dhe shkrimeve që e flasin më pak së 20% nga qytetarët në komunë, përcaktimin dhe shfrytëzimi i stemës dhe flamurit të komunës, përveç shumicës së votave nga anëtarët prezentë, është e nevojshme edhe shumica e votave nga anëtarët prezentë që janë pjesëtarë të bashkësive që nuk janë shumicë në komunë. Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të këshillit janë : të marrin pjesë në punën e këshillit dhe të trupave punuese, të japin propozime dhe inisiativa, si edhe t'i parashtrojnë pyetje prefektit. Anëtarët e këshillit gëzojnë imunitet. Ato nuk mund të thirren në përgjegjësi penale ose të paraburgosen për mendimin e shprehur ose për votimin në këshill. Mandati i anëtarëve të këshillit është katër vjet. Ai ndërpritet me fuqi të Ligjit edhe para skadimit të afatit:

nëse anëtari jep dorëheqje, nëse vdes, nëse është i dënuar me aktgjykim të plotëfuqishëm për vepër penale me dënim burg me kohëzgjatje mbi 6 muaj, në rast të moslidhjes së funksionit sipas Ligjit për zgjedhjet lokale; nëse me vendim të plotëfuqishëm i është hequr aftësia e punës, si edhe kur i ndërpritet banimi në komunë. Anëtarit të këshillit mund ti merret mandati nëse mungon pa arsye në tri mbledhjet e këshillit. Vendimi për marrjen e mandatit sillet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Këshilli mund edhe të vetlëshohet, nëse për atë deklarohet shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve. Me fuqi të Ligjit këshilli lëshohet nëse : për së dyti e sjell dispozitën që më parë ka qenë e anuluar dhe e ndërprer nga Gjyqji Kushtetues i RM, nëse sjell vendim me të cilin rrezikohet sovraniteti dhe integriteti territorial i RM, nëse nuk mbledhet në periudhë më gjatë së 6 muaj dhe nëse nuk e sjell buxhetin dhe llogarinë vjetore të buxhetit deri me 31 mars të vitit vijues. Deri në zgjedhjen e këshillit të ri punët e tij i kryen prefekti i komunës. Ai nuk mund të vendosë për: për çështjet në lidhje me përdorimin e pronësinë komunale, si edhe për çështje në të cilat ai ose bashkëshorti(ja), fëmijët ose farefisi deri në vijën e brezit të dytë anësor, kanë interes financiar apo interes tjetër. Prefekti nuk mund të sjellë dispozita që janë në kompetencat e Këshillit. Me mbledhjet e këshillit udhëheq kryetari, i cili zgjidhet nga rendi i anëtarëve, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, për periudhë prej 4 vitesh. Kryetari i thirr dhe i udhëheq mbledhjet e këshillit, kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit, i nënshkruan dispozitat e sjella në këshill dhe ia dërgon prefektit për shpalljen në afat prej tri ditëve nga sjellja.

Këshilli:

1. Sjell statutin e komunës dhe dispozita të tjera;
2. Sjell buxhetin dhe llogarinë vjetore të komunës;
3. Përcakton shumën e burimeve personale të të ardhurave të financimit të komunës, në suaza të përcaktuara me ligj;

4. Themelon veprimtari publike në suaza të kompetencave të komunës dhe bënë mbikqyrjen mbi punën e tyre;
5. Emëron anëtarë të këshillave drejtues të veprimtarive publike të cilat I themelon;
6. Sjell programe për punë dhe plane financiare për financim të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna;
7. I miraton raportet për realizimin e buxhetit dhe llogarinë vjetore të komunës;
8. Vendos për dhënien e lejeve për kryerje të veprimtarisë të interesit public me rëndësi lokale në përputhje me ligjin;
9. I miraton raportet për punën e veprimtarive publike që i ka themeluar komuna;
10. Vendos për mënyrën e disponimit me pronën e komunës.
11. Vendos mbi mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës në përputhje me ligjin.
12. Zgjedh personin që udhëheq me njësinë rajonale të ministrisë për punë të brendshme në komunë, në përputhje me ligjin;
13. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor për sigurinë publike në territorin e komunës, të cilin e dorëzon deri te ministri i punëve të brendshme dhe avokati popullor;
14. Mund t'i jep rekomandime personit udhëheqës të njësisë rajonale të ministrisë për punë të brendshme nga fusha e sigurisë publike dhe sigurisë në komunikacion dhe
15. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Nëse këshilli nuk i miraton raportet nga paragrafi (1) nënparagrafi (7) dhe (9) të këtij neni mund të ngrejë procedurë për kryerjen e kontrollit të punës materiale dhe financiare pranë organit kompetent për mbikqyrje. (3) Personi udhëheqës nga paragrafi (1) nënparagrafi 12 i këtij neni është zgjedhur nëse për të kanë votuar shumica e gjithë këshillave të komunave të cilat I përfshin njëra rajonale e ministrsë për punë të brendshme.²²

2.2.2 Kryetari komunes

Ligji për vetëqeverisje lokale i vitit 2002 parashef pushtet ekzekutiv monocefal. Prefekti, si organ inokos ekzekutiv, ka kompetenca të gjera dhe kryesore. Ai e paraqet dhe përfaqëson komunën, e kontrollon ligjshmërin e dispozitave të këshillit, i shpall dispozitat e këshillit në gazetën zyrtare komunale, e siguron zbatimin e vendimeve të këshillit , udhëheq me administratën komunale, e siguron zbatimin e punëve të cilat me Ligj i janë të deleguara komunës, inicon dhe propozon sjelljen e dispozitave që janë në kompetencë të këshillit, e propozon buxhetin vjetor, llogarinë vjetore të buxhetit, e zbaton buxhetin , zgjedh drejtorë në shërbimet publike të themeluara nga komuna, vendos për punë administrative për të drejtat , detyrimet dhe interesat e personave juridikë dhe fizikë në pajtim me ligjin etj. Statusi i prefektit del nga mënyra direkte e zgjedhjes së tij. Funkzioni I prefektit është profesional. Në rast mungese ose pengese, ai vendos kush prej anëtarëve do ta zëvendësojë. LVL thotë se kryetari i këshillit nuk mund t'a zëvendësojë prefektin (neni 52 paragrafi 6). Prefekti gëzon imunitet, gjegjësisht nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose paraburgim për mendimin e thënë në këshill. Mandati i prefektit është katër vjet. i njëjti mund t'i ndërpritet më herët, nëse jep dorëheqje, mëse vdes, nëse me aktgjykim të plotëfuqishëm është I dënuar për vepër penale më dënim burg mbi 6 muaj , me vendim të plotëfuqishëm i është marrë aftësia e punës , nëse vjen në moslidhëshmëri te funksionit sipas Ligjit për zgjedhje lokale dhe në rast të mungesës pa arsye më shumë së 6 muaj ose kur i ndërpritet banimi në komunë. Arsyetimin e mungesës e vlerëson këshilli i komunës, me dy të tretat e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit. LVL nga viti 2002 e rregullon edhe konfliktin e interesave të prefektit, duke theksuar se prefekti nuk mund të

²² Vetqeverisja lokale faqe 11,12

emërohet për anëtar të organeve kontrolluse, administrative dhe mbikqyrëse të shoqatave tregtare dhe shërbimeve publike, nuk mund të marrë pjesë në vendimin e çështjeve ku ai ose bashkëshorti(ja) e tij, fëmijët ose farefisi i vijës së dytë anësore, kanë interes financia ose interes tjetër.²³

2.3 Dominimi I fuqisë së kryetarit të komunës në strukturën e kompetencave komunale

²⁴Siç kemi thënë, komuna paraqet njësinë e qeverisjes lokale, si bashkësi e banorëve në një territor të caktuar, e rregulluar me ligj, e cila përmes organeve të veta dhe përmes administratës dhe organizimit të shërbimeve publike, mundëson kryerjen e kompetencave të përshkruara në ligj. Organet e komunës, siç e dimë janë: Këshilli i Komunës dhe Kryetari i Komunës. Këshilli i Komunës është organ përfaqësues i qytetarëve i cili vendos në kuadër të kompetencave të komunës.¹ Sipas Ligjit për Qeverisje Lokale të RMV-së, kompetencat e kryetarit janë: e përfaqëson dhe e prezanton komunën; e kontrollon ligjshmërinë e dispozitave të këshillit; i shpall dispozitat e këshillit të në gazetën zyrtare të komunës; e siguron zbatimin e vendimeve të këshillit; e siguron kryerjen e punëve të cilat me ligj i janë deleguar komunës; inicon dhe propozon sjelljen e dispozitave nga kompetencat e këshillit; e propozon buxhetin vjetor të komunës dhe llogarinë vjetore të buxhetit të komunës; e realizon buxhetin e komunës; zgjedh drejtorë të veprimtarive publike që i ka themeluar komuna, në bazë të konkursit publik; rregullisht e njofton këshillin për kryerjen e kompetencave të veta në përputhje me statutin; vendos në punë administrative për të drejtat, obligimet dhe interesat e personave juridik, fizik, në përputhje me ligjin; sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale; udhëheq me administratën komunale; vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën e komunës, nëse ndryshe nuk është e përcaktuar me ligj; siguron shfrytëzim të drejtë dhe ligjor, mirëmbajtje dhe mbrojtje të pronës së komunës, në përputhje me ligjin dhe statutin; dhe kryen punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me statutin. 2 Pra, ky predominim (mbizotërim) i kompetencave dhe fuqisë juridike-politike e

²³Vetqeverisja lokale faqe 12,13

²⁴ <https://www.pravdiko.mk/koi-nadlezhnosti-gi-ima-gradonachalnikot/>

²⁵ <http://mls.gov.mk/images/laws/Ligji%20i%20veteqeverisjes%20lokale.pdf>

Kryetari të Komunës në strukturën e kompetencave të qeverisjes lokale si dhe në qasjen e resurseve (burimeve) të tij, ndikoi në paraqitjen dhe përforcimin e një modeli që njihet me emërtimin e monopolit monokratik të pushtetit dhe të fuqisë në udhëheqjen e politikave publike lokale dhe në shfrytëzimin e resurseve publike të komunës. Në periudhën kohore deri në vitin 2005, e sot edhe më tepër, pothuajse se krejt kompetencat dhe fuqia e qeverisjes lokale në RMV po koncentrohet (përqendrohet) në postin/funksionin e Kryetarit të Komunës. Kryetari i Komunës përveç asaj që është funksionar i vetëm ekzekutivo-administrativ, ai merr pjesë edhe në funksionin normative (ligjdhënës) të komunës në atë mënyrë që është propozues i autorizuar i vendimeve të Këshillit të asaj komune. Veç kësaj, Kryetari i Komunës udhëheq me shërbimet profesionale dhe administratën e njësisë së qeverisjes lokale. Të punësuarit – stafi punues në administratën komunale drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të plotë varen nga Kryetari i Komunës. Po kështu, Kryetari i Komunës vendos për të drejtat e palëve personave fizik dhe persona juridik në procedurën administrative. Kryetari i Komunes i emëron dhe shkarkon drejtorët e institucioneve të arsimit parashkollor – kopshteve dhe çerdheve dhe drejtorët e institucioneve të arsimit parauniversitar, dmth të shkollave fillore dhe të mesme, emeron dhe shkarkon kryearkitektin e komunes, udhëheqesit e sektoreve të ndryshëm administrativ në kuader të administratës lokale komunale, drejtorët e ndermarrjeve publike lokale komunale, etj. Për më tepër, Kryetari i Komunes e siguron shfrytëzimin dhe mbrojtjen e pronës së qeverisjes lokale, por njëkohësisht është ekskluzivisht kompetent për përmbarrimin (ekzekutimin) e vendimeve të Këshillit të Komunes, si dhe është kompetent edhe për përmbarrimin e buxhetit të njësisë së qeverisjes lokale, duke pasur kompetencë të plotë mbi politikën e përmbarrimit dhe udhëheqjes me punët e qeverisjes lokale. Nga ana tjetër, Kryetari i Komunes, me asgjë nuk varet nga Këshilli i Komunes, poashtu nuk varet me asgjë edhe nga qytetarët mbase për atë nuk është parashikuar as impçimenti (mundësia e marrjes në përgjegjësi juridike-politike me pasoje shkarkimi), as revokimi (heqja e të drejtës për të vazhduar detyrën – mandatin përpara skadimit/mbarimit të kohezgjatjes së mandatit, për të cilën është zgjedhur). Pra, përderisa Kryetari i Komunes është gjallë dhe shëndosh e mirë dhe përderisa në kuptimin

formalo-juridik u përmbahet ligjeve, gjë që është lehtë për t'u realizuar, atë askush nuk mund ta ndërrojë pa marrë parasysh se ai mund ta humb autoritetin, kredibilitetin dhe legjitimitetin e funksionarit publik (funksionarit që është në shërbim të interesave publike të qytetarëve dhe popullsisë lokale). Përballë një pozicioni të tillë të Kryetarit të Komunes, Këshilli i Komunes ka një pozicion juridik dukshëm më të dobët. Këshilli i Komunes miraton akte dhe vendime, duke rregulluar disa lëmi dhe çështje në mënyrë të përgjithshme me çka e normon kornizën e politikave publike lokale.⁵ Kupohet se kjo gje, paraqet një dimension mjaft të rëndësishëm për jetën dhe interesat e komunitetit lokal dhe për funksionimin e qeverisjes lokale, mirepo, krejt këto akte dhe vendime i përgatit dhe siguron shërbimi profesional normativ dhe administrativ lokale komunale, nderkaq, i verifikon, propozon dhe realizon kryetari i komunes. Në mënyrë plotësuese, mozaiku i tillë rrumbullaksohet me faktin se, vetë qytetarët janë subjekti më i dobët në konceptin e qeverisjes lokale në RMV-se. Qytetarët pas aktit të zgjedhjeve lokale demokratike nuk kanë asnjëfarë pozicioni apo akses (qasje) në praktikimin e qeverisjes lokale. Institutet (mekanizmat) e demokracisë së drejtpërdrejtë, siç janë: iniciativat (nismat) dhe tubimet e qytetarëve, janë modele tepër të dobëta për rolin e qytetarëve në qeverisjen lokale në RMV. Këto mekanizma janë difuze, shumë rëndë vihen në lëvizje dhe si një kurorë e kësaj-krejt ajo që mund të del si konkluzë e tyre, nuk është e detyrueshme për organet e qeverisjes lokale. Pra, krejt dhe çdo përpjekje e qytetarisë lokale varet nga konstatimi dhe vullneti i Kryetarit të Komunes dhe Këshillit të komunës. Krejt ky domen i participimit të qytetarëve në qeverisjen lokale paraqet një domen “që ri pezull në ajër”, pa mekanizma të duhura për ndikim efektiv ndaj organeve të qeverisjes lokale. Deri në vitin 2002, pra, deri në Ligjin e ri për qeverisjen lokale, qytetarët kishin mundësi që të votojnë lidhur me votëbesimin e Kryetarit të Komunes, të cilin vetë e kanë zgjedhur në zgjedhje të drejtpërdrejta lokale demokratike. Ky instrument paraqiste një mundësi për të provuar legjitimitetin e Kryetarit të Komunes si dhe për të sendërtuar (realizuar) verifikimin (miratimin/vertetimin) demokratik të punës së tij nga aspekti i interesave të popullsisë lokale. Mirëpo, ky instrument, u abrogua (shfuqizua) me Ligjin aktual të qeverisjes lokale të vitit 2002, kështu që, sot, normativisht dhe praktikisht, është në fuqi juridike pozicioni i paprekshëm i Kryetarit të Komunes.

Kryetari i komunës në suaza të kompetencave të veta:

- inicion dhe propozon miratimin e dispozitave në kompetencë të Këshillit të Komunës;
- siguron kryerjen e punëve të përcjella nga organet e administratës shtetërore;
- propozon buxhetin vjetor dhe llogarinë vjetore të buxhetit të Komunës;
- e realizon buxhetin e Komunës;
- vendos për punë administrative për të drejtat, detyrimet dhe interesat e personave juridikë dhe fizikë, në pajtim me ligjin;
- udhëheq me administratën komunale;
- harton rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale;
- vendos për punësimin, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve në administratën komunale nëse nuk është caktuar ndryshe me ligj;
- ushtron edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me këtë statut.
- ka të drejtë të jetë i pranishëm dhe të marrë pjesë në punën e seancave të Këshillit.

Kryetari i komunës i shpall dispozitat e Këshillit në Fletoren zyrtare të Komunës .

Kryetari i komunës siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Kryetari i komunës është i detyruar në afat prej 7 (shtatë) ditësh prej ditës së dërgimit të dispozitës së Këshillit me aktvendim ta ndalë shpalljen e tij nëse mendon se nuk është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet. Një shembull të aktvendimit të arsyetuar për mos shpallje i dërgohet kryetarit të Këshillit të Komunës.

Këshilli është i detyruar në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së shpalljes së aktvendimit ta shqyrtojë dhe të vendos për të. Nëse Këshilli e vërteton dispozitën ose nuk diskuton në afat nga paragrafi 3 i këtij neni, prefekti është i detyruar ta shpall dispozitën dhe njëkohësisht të ngre nismë përngritjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë të dispozitës së kontestuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

Për nismën kryetari i komunës është i detyruar ta informojë ministrinë kompetente për kryerjen e punëve që i përkasin vetëqeverisjes lokale.

Kryetari i komunës është i detyruar të paraqesë raport për zbatimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli çdo 3 (tre) muaj gjatë vitit.

Për ushtrimin e kompetencave të veta kryetari i komunës e informon Këshillin sipas nevojës, po më pak 2 (dy) herë në vit.

Kryetari i komunës udhëheq me pronën e Komunës si nikoqir i mirë.

Në udhëheqje me pronën e Komunës Kryetari i komunës është i detyruar të marrë masat dhe të sigurojë shfrytëzim të pronës në pajtim me ligjin.

Gjatë kohës së pengesës ose të mungesës deri në gjashtë muaj kryetarin e komunës e zëvendëson anëtar i Këshillit të Komunës të cilin e cakton prefekti.

Në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së marrjes së funksionit kryetari i komunës është i detyruar me aktvendim ta caktojë anëtarin e Këshillit i cili do ta zëvendësojë.

Aktvendimi nga paragrafi 2 i këtij neni shpallet në Fletoren zyrtare të Komunës .

Për ditën e fillimit të pengesës ose të mungesës kryetari i komunës e informon kryetarin e Këshillit. Anëtarit të Këshillit i pushon funksioni i anëtarit të Këshillit gjatë kohës kur e zëvendëson kryetarin e komunës.²⁵

2.4 Raportet midis pushtetit qendror dhe lokal

Organet shtetërore , sipas LVL, janë të detyruara në afat të caktuar dhe në mënyrë adekuate t'i konsultojnë organet komunale kur vendosin për çështje që u dedikohen atyre. Mënyra e konsultimeve përcaktohet me ligjet nga sfera përkatëse. Konsultimet janë të domosdoshme edhe gjatë përgatitjes së planit hapsinor të Republikës (neni 78 paragrafi 20). Bashkëpunimi zhvillohet edhe nëpërmjet lidhjes së kontratave ndërmjet shtetit dhe komunave. Qeveria, për shkak të kordinimit gjatë planifikimit, programimit dhe implementimit të politikave në sfera të caktuara, mund të lidhë kontrata për bashkëpunim me një ose më shumë komuna, për çka informohet Kuvendi i RM. Sipas nenit 80 nga LVL, Qeveria është e detyruar të bashkëpunojë me komunat kur sillen ligje që u dedikohen komunave, kur përcaktohet shuma e dotacionit të përgjithshëm që duhet tu ndahet komunave në vitin vijues kalendarik, si dhe

²⁵ o-jegunovce@mt.net.mk 23-03-2020

për burimin e financave dhe të kompetencave. Më tutje Ligji insiston të përgatitet raport në të cilin do të evidentohen çështjet për të cilat është arritur pëlqim dhe për ato për të cilët nuk është arritur pëlqim. Gjatë propozimit të ligjit që i prek interesat e komunave ,atij detyrimisht i shtohet raporti i lartpërmëndur. LVL përmban dispozita themelore për Shoqatën e komunave të RM, si institucion për mbrojtje dhe përparim të interesave të përbashkëta të komunave. Duke u nisur nga e drejta e bashkimit të komunave në forma të ndryshme fakultative, në nenin 81 të Ligjit thuhet se shoqata e cila përfshin më tepër se dy të tretat nga komunat në tërë territorin e shtetit ka të drejtë të prezantohet si përfaqësues legjitim i komunave , gjegjësisht të bashkëpunojë me Qeverinë në emër të tyre, të iniciojë sjellje të ligjeve që u dedikohen përparimit të vetëqeverisjes lokale, si dhe të japë propozime për projektimin e propozimit të buxhetit të RM në pjëesën që i dedikohet ndarjes së mjeteve të komunave për kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligj. Gjithashtu, shoqata e komunave e RM, në të cilën bëjnë pjesë më tepër se dy të tretatnga komunat e përfaqëson RM në organizatat ndërkombëtare të pushteteve lokale dhe bashkëpunon me organizata të përafërta nga vende të tjera. Themelimi,organizimi, funksionimi dhe regjistrimi i shoqatës rregullohet me ligj të veçantë.(1)Qeveria bashkëpunon me komunat për çështjet që janë në interes të tyre dhe atë:

-ligjet që kanë të bëjnë me komunat;

-shuma e dotacionit të përgjithshëm që duhet t'u ndahet komunave gjatë vitit vijues kalendarik-burimet e financimit të kompetencave.²⁶

(2) për bashkëpunimin për çështjet e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni përgatitet raport në të cilin përfshihen çështjet për të cilat është arritur pajtueshmëri dhe çështjet për të cilat nuk ka pajtueshmëri.(3) Me ligjin që ka të bëjë me çështjet nga paragrafi (1) i këtij neni

deri te Kuvendi I Republikës së Maqedonisë dorëzohet edhe raporti nga paragrafi (2) i këtij neni.

²⁶ Vetqeverisja lokale faqe 16

2.5 Demokracija lokale dhe transparencja

²⁷Në të gjitha përkufizimet e qeverisjes lokale, theksi gjithmonë bie te qytetarët, të cilët kanë të drejtë në udhëheqjen e punëve publike me interes të përbashkët. Pra, demokracia lokale, gjithmonë na çon në historinë e hershme, në periudhën e organizimit të lagjeve të shtet-poliseve greke, ku qytetet paraqiteshin si “tërësi të pavarura me rregullim të administratës nga ana e vet banorëve, të cilët edhe i kryenin punët me interes për vetën e tyre”. 3 Kështu, edhe format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrje, të garantuara edhe me aktin më të lartë juridik të shtetit, kushtetutën, kjo nënkupton se në njëfarë mënyre ende në qeverisjen lokale ka forma të demokracisë së drejtpërdrejtë (qeverisja e popullit) që nënkupton atë lloj të demokracisë ku populli drejtpërdrejtë vetë është organ shtetëror dhe vetë i miraton vendimet, pra vetë e ushtron pushtetin shtetëror. Mirëpo, ky lloj i demokracisë, në formë specifike ka ekzistuar në Greqinë Antike në polisët (qytet-shtetet) greke, ndërkaq, sot flitet vetëm për disa forma të saj, sepse sot, demokracia përfaqësuese dominon në botë, sepse vetë popullit nuk mund t’i ushtrojë punët profesionale shtetërore të cilat kërkojnë njohje profesionale të specialistëve, të cilën populli nuk e ka. Prandaj, sot ekzistojnë disa forma të ushtrimit të demokracisë së drejtpërdrejtë. 4 Në dy dekadat e fundit në vendin tonë decentralizimi i pushtetit është në fokusin e jetës politike dhe administrative. Në vitin 1999 Qeveria miratoi Strategjinë për reforma të qeverisjes lokale. Realizimi i suksesshëm i reformës për qeverisje lokale, duhet përfshirë edhe decentralizimin, është detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me BE-në (2001) dhe nga Vendimi I Komisionit Evropian për fillimin e procesit të negociatave për anëtarësim në BE. Në vitin 1997 vendi ynë nënshkroi Kartën për Qeverisjen Lokale të Këshillit të Evropës, e në vitin 2013 protokollin drejt Kartës, që u ratifikua në vitin 2015 dhe hyri në fuqi në vitin 2016. Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e nënshkruar në vitin 2001 dhe amendamentet kushtetuese nga nëntori i vitit 2001, nxitën reformën e qeverisjes lokale. Si rezultat i kësaj, në janar të vitit 2002 u miratua Ligji i ri për Qeverisje Lokale. Në vitin 2003, Qeveria miratoi Programin Operativ për Decentralizim, që përmban listë ligjesh që kanë të

²⁷ Qeverisja lokale, Agni Aliu, Esat Stavileci;

²⁸bëjnë nga afër me decentralizimin. Kësaj liste, përveç ligjeve kyçe sistemore (Ligji për organizimin territorial, Ligji për financimin e njësive të qeverisjes lokale, Ligji për Qytetin e Shkupit) iu shtua edhe një numër i madh i ligjeve plotësuese (mbi 80), që rregullojnë transferimin faktik të kompetencave dhe resurseve, sipas Ligjit për qeverisje lokale. Sipas Kushtetutës dhe ligjit, të gjitha njësitë e qeverisjes lokale janë të pavarura në kryerjen e kompetencave të tyre, ndërsa kontrolli i ligjshmërisë së punës së tyre është kompetencë e ushtetit qendror. Më 1 korrik 2005, njësitë e qeverisjes lokale filluan me ushtrimin e kompetencave të reja në kushte organizimi të ri territorial të qeverisjes lokale, me përfaqësues të sapozgjedhur të qeverisë lokale dhe me mënyrën e re të financimit të njësive të qeverisjes lokale, të ashtuquajturin decentralizim fiskal. E gjithë kjo zhvillohej në dy faza, për shkak të ndërtimit gradual të kapaciteteve fiskale dhe administrative të njësive të qeverisjes lokale në vend. 5 Ndërkaq, sa i përket transparencën kjo ndërlidhet shumë me demokracinë në përgjithësi, por edhe me demokracinë lokale në veçanti, duke pasur parasysh se bashkësitë lokale, përkatësisht qeverisja lokale nën parimin e subsidiarititeti, nënkupton afrimin e organeve të qeverisjes lokale sa më afër qytetarëve, dhe fundja qytetarët janë taksapaguesit e rregullit në komunën ku jetojnë dhe kështu ata posedojnë shumë të drejta që të jenë të informuar por edhe t'i thirrin në përgjegjësi autoritetet lokale. Prandaj, transparenca paraqet parimin thelbësor të qeverisjes së mirë. Qasja e lire në informata luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, megjithatë, duhet të jepet në kohë, të jetë relevant, i saktë dhe i plotë për t'u përdorur në mënyrë efektive. Çështjet se kush e prodhon atë informacion, dhe për çfarë qëllimi bëhen aspekte kyçe të transparencës, kur interes konkurren të konvergojnë në një çështje të veçantë. Një nga modelet më të avancuara për sigurimin e transparencës është korniza pesëpikëshe për rritjen e transparencës: 1. Vlerësim dhe monitorim; 2. Qasje në informacion; 3. Etikë dhe integritet; 4. Reformë institucionale; dhe 5. Trajtimi i çështjeve specifike. 6 Edhe përkaj rregullimit të mënyrës së realizimit të së drejtës për qasje të lire në informacione me karakter public, Ligji për qasje të lire në informacione me karakter public, i përcakton edhe informacionet që poseduesit e informacionit, mes të cilëve edhe njësitë e

²⁸ "Fillet e së drejtës" Prof. Jeton Shasivari;

²⁹qeverisjes lokale është e nevojshme që t'i publikojnë në web-faqet e tyre, edhe atë: ligjet dhe aktet nënligjore; njoftime për publikun mbi punët të ndërmarra nga ana e tyre në përputhje me kompetencat ligjore; të dhëna statistikore për punën e tyre; raporte për punën që l dorëzojnë deri te organet kompetente për realizimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes të paraparë me ligj, t'i bëjnë të mundshme që të gjitha informacionet të jenë publike; propozim- programet, programet, strategjitë, qëndrimet, mendimet, studimet dhe dokumente të tjera të ngjashme; dhe informacione tjera që dalin nga kompetenca dhe puna e tyre. ³⁰7 Së këndjemi, janë bërë shumë analiza mbi konceptin e të ashtuquajturës "veb-transparenca), mbi informacionet e ndryshme se sa komunat l postojnë në veb-faqet e tyre. Lista e informacioneve që janë paraqitur ka qenë formuar si rezultat l detyrimeve ligjore të komunave që të publikojnë informacione me karakter publik ose informacione të cilët rrjedhin nga puna e tyre dhe shërbimet të cilët l sigurojnë, nga detyrimet ligjore të definuara në material të caktuara ligjore për mbajtjen e regjistrave të caktuar, evidence të të dhënave, si dhe në përputhje me nevojat e theksuara të qytetarëve për informacione të caktuara shitesë. Hulumtimet kanë treguar se vetëm në vitin 2018, komunat indeks mesatar të veb-transparencën diku 20.47%, përkatësisht, publikohen përafërsisht 1/5 e informacioneve të cilët duhet t'i mbledhin dhe publikojnë, si dhe të atyre të cilët qytetarët konsiderojnë se duhet të publikohen. Indeksi l veb-transparencës ka vërejtur se ka rritje të vogël në krahasim me vitin 2016, e cila ka qenë 15,,89%. Kjo d.m.th. se qeveritë e reja lokale duhet të kontribuojnë edhe më tepër në sigurimin e transparencës së punës së tyre përmes publikimit të informacioneve relevante në veb-faqet e komunës.³¹

²⁹ Doracak për promovimin e parimeve të qeverisjes demokratike në këshillat e njësive të vetëqeverisjes lokale.

³⁰ https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/EC_Transparenca_lokale_ne_Prizren.pdf

³¹ file:///C:/Users/Lenovo/Downloads/CUP_Istrazuvanje.pdf

2.5.1 Iniciativa qytetare

(1) Qytetarët kanë të drejtë t'i propozojnë këshillit që të sjell akt të caktuar ose të zgjedh një çështje të caktuar nga kompetencat e veta.

(2) Inicativë qytetare nuk mund të paraqitet për çështje kadrovike dhe financiare.

(3) Për propozimin nga paragrafi (1) këshilli është i obliguar që të debatojë nëse e mbështesin më së paku 10 % e zgjedhësve të komunës, respektivisht të vetëqeverisjes vendore të cilës i dedikohet çështja e përcaktuar.

(4) Debatin nga paragrafi (3) i këtij neni, këshilli është i obliguar ta mbajë më së voni në afat prej 90 ditësh pas iniciativës së dorëzuar dhe t'i informojë qytetarët për vendimin e vet.³²

2.5.2 Tubimi i qytetarëve

(1) Tubimi i qytetarëve mund të thirret për territorin e mbarë komunës ose për territorin e vetëqeverisjes vendore.

(2) Tubimin e qytetarëve e thërret prefekti i komunës me iniciativë të vet, me kërkesë të këshillit ose me kërkesë të më së paku 10 % të zgjedhësve të komunës, respektivisht të vetëqeverisjes vendore të cilës i dedikohet çështja e përcaktuar.

(3) Organet e komunës janë të obliguara që në afat prej 90 ditësh t'i shqyrtojnë konkluzat e sjellura në tubimin e qytetarëve dhe t'i marrin parasysh gjatë marrjes së vendimeve dhe sjelljes së masave lidhur me çështjet që u dedikohen, si dhe t'i informojnë qytetarët për vendimet e veta.³³

³² Ligji për vetqeverisje lokale neni 26

³³ Ligji për vetqeverisjen lokale neni 27

2.5.3 Referendumi

(1) Qytetarët përmes referendumit mund të vendosin për çështje nga kompetencat e komunës, si dhe për çështje të tjera me rëndësi lokale.

(2) Këshilli është i obliguar të shpall referendum me kërkesë të më së paku 20% të zgjedhësve në komunë.

(3) Këshilli mund të shpall referendum për çështje nga kompetencat e veta me iniciativë të vet.

(4) Vendimi i dalur nga referendumi është obligues për këshillin.³⁴

2.6 Mbrojtja juridike kushtetuese e autonomies lokale në RMV

Mbrojtja e pozitës kushtetuese të komunës

Këshilli dhe prefekti munden të paraqesin para Gjyqit kushtetues të Republikës së Maqedonisë iniciativë për vlerësimin e kushtetueshmërisë së ligjeve dhe kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithëshme të ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetore me të cilat çrregullohet pozita kushtetuese e komunës të përcaktuara me kushtetutën dhe ligjet.³⁵

Mbrojtja gjyqësore e komunave

Komunave u garantohet mbrojtja gjyqësore para gjyqeve kompetente lidhur me aktet dhe aktivitetet e organeve të administratës shtetore dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me të cilat pengohet kryerja e kompetencave të përcaktuara me ligj.³⁶

³⁴ Ligji për vetqeverisjen lokale neni 28

³⁵ Ligji për vetqeverisje lokale neni 87

³⁶ Ligji për vetqeverisje lokale neni 88

Mbrojtja gjyqësore e qeverisjes lokale

³⁷Kushtetuta e RMV-së, ai akt më i lartë juridik i shtetit, ua garanton qytetarëve të drejtën e qeverisjes lokale edhe atë me nenin 114 ku edhe qartë thekson se njësitë e qeverisjes lokale janë komunat. Pra, garantimi i bashkësis lokale në vendin tonë bëhet në nivel kushtetues. Po ashtu, me Ligjin për Qeverisje Lokale të RMV-së, në nenin 88-të theksohet se komunave u garantohet mbrojtje gjyqësore para gjyqeve kompetente lidhur me aktet dhe aktivitetet e organeve të administratës shtetërore dhe Qeverisë së RMV-së me të cilat pengohet kryerja e kompetencave të përcaktuara me ligj.³⁸ 10 Kjo gjë, vërehet edhe te kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, e cila në realizimin e kompetencave klasike të gjyqësisë kushtetuese, Gjykata Kushtetuese zgjidh konfliktin e kompetencave mes bartësve të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe konfliktin për kompetencë mes organeve të Republikës dhe njësive të qeverisjes lokale. E prirur në mbrojtjen e principit të ndarjes së pushtetit dhe drejt mbrojtjes së qeverisjes lokale, si vlera themelore të rendit kushtetues të RMV-së, këtë kompetencë mund ta ketë edhe në rastet positive por edhe ato negative kur këto organe bien në konflikt të kompetencë. ³⁹Në praktikë, megjithatë, rrallë inician këso konteste, por Gjykata shumë shpesh, edhe atë esencialisht zgjidh konteste të tilla përmes kontrollës së kushtetutshmërisë së akteve normative me anë të së cilëve organeve të caktuara u përshkruhen kompetencat të cilët me Kushtetutë u takojnë. 11 Kështu është rasti që e gjejmë në vendimin e Gjykatës Kushtetuese me numër 201/2007-0-1, me anë të së cilës, Gjykata Kushtetuese duke cituar nenet e Kushtetutës thekson se sundimi i së drejtës si dhe qeverisja lokale, janë një ndër vlerat themelore të rendit kushtetues të RMV-së dhe se pavarësisht çfarë vendime mund të bijnë jo vetëm organet e qeverisjes lokale por edhe më gjerë duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën. ⁴⁰Sipas saj, me nenin 115-të të Kushtetutës së RMV-së, komuna është njësi e qeverisjes lokale dhe është e pavarur në kryerjen e kompetencave të theksuara në Kushtetutë dhe ligje, kurse mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së saj e kryen Republika. Republika me ligj mund t'i besojë kryerjen e disa punëve të caktuara komunës. Pra, edhe te

³⁷ Дали единиците на локалната самоуправа ги исполнуваат стандардите за добро управување?

³⁸ Kushtetuta e RMV-së, neni 114;

³⁹ Ligji për Qeverisje Lokale të RMV-së, neni 88;

⁴⁰ http://ustavensud.mk/?page_id=4597

⁴¹Ligji për Qeverisjen Lokale, thotë vendimi i Gjykatës Kushtetuese, edhe atë në nenin 22 është e theksuar lista e kompetencave të komunës. Ashtu që, komunat janë kompetente në kryerjen e punëve në vijim:

- Planifikimi urbanistik (urban dhe rural), dhënia e lejes për ndërtim të objekteve me rëndësi lokale të përcaktuara me ligj, rregullimi i hapësirës dhe rregullimi i tokës ndërtimore;

- Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe natyrës – masa për mbrojtje dhe pengimin nga ndotja e ujit, ajrit, tokës, mbrojtja e natyrës, mbrojtja nga zhurmimi dhe rrezatimi jonizues;

- Zhvillimi ekonomik lokal – planifikimi i zhvillimit ekonomik lokal; përcaktimi i përparësive zhvillimore dhe strukturale, udhëheqja me politikën ekonomike; përkrahja e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të iniciativave në nivel lokal dhe në atë kontekst pjesëmarrja në vendosjen dhe zhvillimin e rrejtit lokal të institucioneve dhe agjencive dhe promovimi i parnteritetit;

- Veprimtaritë komunale- furnizimi me ujë për pije; përcjellja e ujit teknologjik; përcjellja dhe pastrimi i ujrave të ndotura; ndriçimi publik; dërgimi dhe trajtimi i ujrave atmosferik; mirëmbajtja e higjienës publike; grumbullimi, transportimi dhe procedimi me mbeturinat e ngurta komunale; rregullimi dhe organizimi i trafikut publik lokal të udhëtarëve; furnizimi me gaz natyror dhe energji ngrohëse; mirëmbajtja e varreve, varrezave, krematoriumeve dhe dhënia e shërbimeve mortore; ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale, rrugëve dhe objekteve të tjera të infrastrukturës; rregullimi i regjimit të komunikacionit; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimeve rrugore të komunikacionit, ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirës publike të parkimit; mënjanimi i automjeteve të parkuara gabimisht; mënjanimi i automjeteve të dëmtuara nga sipërfaqet publike; ndërtimi dhe mirëmbajtja e tregjeve; pastrimi i oxhaqeve; mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i parqeve, gjelbërimit, park-pyjeve dhe sipërfaqeve rekreative; rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i shtratit të lumenjve në pjesët e urbanizuara; përcaktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera të infrastrukturës.

⁴¹ <http://ustavensud.mk/?p=9505>, ose Ligji për Qeverisje Lokale i RMV-së, neni 22;

⁴²- Kultura-përkrahja institucionale dhe financiare të enteve dhe projekteve kulturore; kultivimi i folklorit, zakoneve, artizanateve të vjetra dhe vlerave të ngjashme kulturore; organizimi i manifestimeve kulturore; nxitja e formave të llojllojshme specifike të krijimtarisë;

- Sporti dhe rekreacioni-zhvillimi i sportit masiv dhe i aktiviteteve rekreative; organizimi i shfaqjeve dhe manifestimeve sportive; mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve për sport; përkrahja lidhjeve sportive;

- Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve-çerdhe për fëmijë dhe shtëpi të pleqve (pronësi, financim, investime dhe mirëmbajtje); realizimi i përkujdesjes sociale për persona invalidë; fëmijëve pa prindër dhe përkujdesje prindërore; fëmijëve me problem edukativo-sociale; fëmijëve me nevoja të veçanta; fëmijëve nga familjet njëprindërore; fëmijëve në rrugë; personave të ekspozuar rrezikut social; personave të prekur nga keqpërdorimi i drogës dhe alkoolit; ngritja e vetëdijes së popullatës; strehimi i personave të rrezikuar social; realizimi i së drejtës dhe edukimi i fëmijëve të moshës parashkollore.

Kryerja e këtyre kompetencave është në pajtueshmëri me programin nacional për zhvillim të mbrojtjes sociale;

- Arsimi-themelimi, financimi dhe administrimi i shkollave fillore dhe të mesme, në bashkëpunim me pushtetin qendror, në pajtueshmëri me ligjin, organizimi i transportit dhe ushqimit të nxënësve dhe vendosja e tyre në konvikte nxënësish;

- Mbrojtja shëndetësore-të drejtuarit me rrjetin e organizatave publike shëndetësore dhe me objektet nga mbrojtja shëndetësore primare të cilët duhet ta përfshijnë përfaqësimin e qeverijes lokale në të gjitha këshillat të të gjitha organizatave në pronësi publike, edukata shëndetësore; përparimi i shëndetit; aktivitete preventive; mbrojtja e shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtja gjatë punës; mbikëqyrja shëndetësore mbi mjedisin jetësor; mbikëqyrja mbi sëmundjet ngjitëse; ndihmë pacientëve me nevoja speciale (për shembull,

⁴² <http://ustavensud.mk/?p=9505>

shëndeti mental, keqpërdorimi i fëmijëve etj.) dhe lëmenj të tjerë që do të përcaktohen me ligj;

- Zbatimi i përgatitjeve dhe ndërmarrja e masave për mbrojtjen dhe shpëtimin e qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërrimet e luftës, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe nga pasojat e shkaktuara nga to;

- Mbrojtja kundër zjarrit që e kryejnë njësitë territoriale kundër zjarrit;

- Mbikëqyrja mbi kryerjen e punëve nga kompetenca e saj; dhe

- Punë të tjera të përcaktuara me ligj; 12

⁴³Pra, konkretisht në vendimin në fjalë, bëhet fjalë për koncesionin, përkatësisht vendimin për miratimin e procedurës për shitje, dhënie nën koncesion dhënia me qira afatgjate të pronës në pronësi të RMV-së, që e ka sjellur këshilli i komunës e Çuçer-Sandevës me nr. 07-241/5 me 11.03.2006. Sipas Gjykatës Kushtetuese, edhe pse lista e kompetencës së komunave është e gjerë, prap se prap siç thamë, të gjitha vendimet e saja duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet duke u nisur nga fakti se komuna nuk ka as bazë kushtetuese dhe as ligjore, për miratojë pjesëmarrjen e saj në procedurat e organeve shtetërorë, organeve të tjera dhe organizatave në shitje, dhënie nën koncesion dhe qira afatgjate toka dhe objekte që janë në pronësi të RMV-së, pavarësisht se ato janë në territorin e komunës. 13 Edhe njëherë për në fund, si përmbylle të kësaj pjesë të punimit, do të theksojmë se Gjykata Kushtetuese e sulmuar për shkak të procedurave që i ka rrëzuar disa vendime të komunave si njësi të qeverisjes lokale, mirëpo duhet cekur se Gjykata Kushtetuese është organ që e mbron Kushtetutën, dhe askush madje edhe vetë ajo nuk është mbi kushtetutën, andaj pavarësisht kritikave, mbrojtja e komunës nga kushtetuta, rrjedhimisht edhe nga Gjykata Kushtetuese shkon më tej sesa që mendohet, pra kur bëhet fjalë për mbrojtjen gjyqësore të qeverisjes lokale, duhet të kemi parasysh nenin 87 të Ligjit për Qeverisje Lokale i RMV-së, ku thotë se: “Këshilli dhe prefekti munden të paraqesin para

⁴³ Ligji për Qeverisje Lokale i RMV-së, neni 87;

Gjyqit Kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve dhe kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të ministrave dhe organeve tjera të administratës shtetërore me të cilat çrregullohet pozita kushtetuese e komunës së përcaktuara me kushtetutën dhe ligjet.” 14 Nga kjo, kuptojmë se mbrojtja e saj gjyqësore, konsiston në kontestimin e çdo vendimi, iniciative, apo akti që tenton në minimizimin e rolit si dhe të degradimit të pozitës së komunave, apo bashkësive lokale nga organet më të larta (eprore) dhe dhënia e së drejtës së qeverisjes lokale që këto akte t’i godet, apo t’i kontestojë në Gjykatën Kushtetuese, përkatësisht të dërgojë iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të organeve shtetërore, të cilët tentojnë çrregullimin apo degradimin e pozitës kushtetuese që ia njeh qeverisjes lokale Kushtetuta e RMV-së. Pra, me këtë rast obligohet Gjykata Kushtetuese t’i del në mbrojtje qeverisjes lokale, edhe pse pamë deri më tani, raste të tilla nuk janë paraqitur në Gjykatën Kushtetuese të RMV-së.

KAPITULLI I TRETË

KAPACITETET E DECENTRALIZIMIT DHE TRANSPARENCËS SË KOMUNËS SË STUDENIÇANIT-

STUDIM RASTI

3.1 Struktura territoriale dhe historiku I komunës së Studeniçanit

Pozicioni gjeografik

Komuna e Studeniçanit zë pjesën jugore dhe jugperëndimore të luginës së Shkupit, si një zonë e dikurshme e komunës së Kisela Voda. Në territorin e tij buron lumi Kadina. Zona e kësaj komune ka një shumëllojshmëri të strukturave të relievit, pasi që shumica e saj është kodrinore - malore, e vendosur midis maleve të Gushenicës dhe Karadzicës, d.m.th. i përket vargmalit Jakupica. Kufizohet me komunat Sopishtë, Kisela Voda, Zelenikovo, Caska, Makedonski Brod dhe Petrovec.

Territori i Komunës së Studeniçanit përfshin një sipërfaqe prej 274 km² dhe është një nga komunat e mesme në Republikë. Dendësia mesatare e popullsisë është 62 banorë për km², që është një mesatare relativisht e mirë për sa i përket natyrës kodrinore dhe malore të komunës.

Komuna e Studeniçanit ka 19 vendbanime, 18 prej të cilave ekzistojnë dhe një fshat është zhvendosur plotësisht (Kaldirec). Vendndodhja dhe selia qendrore e komunës është Studenicani me 4.582 banorë. Vendbanimet e tjera janë: Batinci, Drachevica, Dolno Kolicani, Gorno Kolicani, Crvoda Voda, Aldinci, Cvetovo, Elovo, Crn Vrv, Markova Sushica, Vrtkica, Malchishte, Umovo, Pagarusha, Osinchani and Ramini.

Më i madhi prej tyre është Batinci me 4,109 banorë.⁴⁴

⁴⁴ https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Studeni%C3%A7anit (29-11-2020)

Historiku I Komunës

Lugina e Shkupit në të cilën ndodhet rajoni i planifikimit të Shkupit, i cili sot i përket Komunës së Studeniçanit, dikur, si tani, kishte një pozicion qendror brenda Ballkanit të Mesëm. Në të kaluarën e largët, Lugina e Shkupit ishte në mes të rrugës ndërmjet lëvizjeve të Vardarit dhe Moravian si një kryqëzim rrugësh madhore nga veriu në jug dhe perëndimi në lindje si një lidhje midis Kosovës dhe perëndimit - luginat maqedonase nga njëra anë dhe lindja - luginat maqedonase nga ana tjetër. . Kjo krijon rëndësinë qendrore gjeo - politike të luginës së Shkupit e cila ka pasur një ndikim të thellë në historinë politike dhe kulturore të këtij rajoni, si dhe në kontaktet dhe ndikimet e rajoneve të tjera të rëndësishme të së kaluarës.

Para ardhjes së Romakëve, d.m.th. V dhe IV para Krishtit. ka pasur përpjekje për të urbanizuar vendbanimet dhe janë ndërtuar vendbanime të fortifikuara që mbështeteshin në përvojat helene dhe në shembuj nga Egjeu dhe Mesdheu Lindor. Këto vendbanime janë përpjekur të planifikojnë brendësinë, të maksimizojnë funksionalitetin e saj, ta formësojnë atë estetikisht dhe për një fortifikim të një cilësie më të mirë. Nga kjo periudhë është qyteti ("Isar" - Kale) afër Studenicani. Muret mbyllnin një sipërfaqe prej 2.5 ha, por pasuria e gjetjeve lëvizëse e veçon atë nga vendet e tjera në rajonin e Shkupit - përveç argjendarisë, vazove luksoze prej argjendi dhe bronzi, vazo të pikturuara të tipit Attic, armë, pitos të mëdhenj [*] Prodhimi lokal i vazove të pikturuara për modelin e mallrave të importuara nga jugu konfirmohet gjithashtu këtu. Gjithashtu në Studenicani, sipër partive të shtëpisë u gjetën koka në formë palmetto. antefiksi.

Përveç qytetit të Studenicani, në territorin e komunës së tanishme të Studeniçanit gjenden edhe depozita "Vrnjak" në Markova Sushica. Këto qytete të fortifikuara nga periudha parahelenistike nuk vdisnin për shkak të pushtimeve dhe pushtimeve galike në fund të shekujve IV dhe fillimit të shekujve III para Krishtit. si dhe pushtimin e dardanëve nga veriu i Kosovës në të njëjtën periudhë. Dardanasit mbetën në këto zona deri në ardhjen e Romakëve.

Me epokën romake dhe ardhjen e romakëve në shekullin III dhe II para Krishtit. filloi urbanizimi i vërtetë i Luginës së Shkupit. Qytetet që u krijuan në atë kohë ishin ndërtuar sipas parimeve italo-romake me një skemë të brendshme, me një plan urbanistik të ndërtesave publike, me një

sistem komunitar-higjienik, me rrugë të shtruara, kanalizime, ujësjellës.

Përveç rrugëve, është e njohur në histori se Romakët i dhanë një rëndësi të veçantë ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për rajonin e Shkupit pasi rrugët romake janë përdorur në kohën e vonë romake dhe të hershme bizantine për të kushtëzuar zhvillimin ekonomik dhe kulturor të rajonit - qendrat tregtare u ndërtuan në kryqëzime me kulla vrojtimi dhe qytete të fortifikuara, kovaçë. Në periudhën nga I deri në VI . Një numër vendbanimesh dhe kështjellash janë ndërtuar në territorin e komunës aktuale të Stidenichani, të cilat tregojnë për popullsinë e vazhdueshme të kësaj zone, si dhe zhvillimin antik të popullsisë së atëhershme. Vendbanime dhe kala të tilla janë "Kale" dhe "Mumdzica" në Albinci, "Gradiste" në Dolno Kolicane, "Kale" në Dracevica, "Isar" në Elovo, "Kalja" në Crni Vrv. Gjatë vendosjes së sllavëve nuk kishte gjetje të shkruara apo kulturore. Historia e mesjetës për rajonin e Shkupit daton që nga fundi i shekullit X me mbretërimin e Tsar Samoil kur Shkupi dhe rrethinat e tij ishin një pikë e rëndësishme strategjike e mbrojtjes. Me fitoren e fundit bizantine mbi Tsar Samoil, Shkupi dhe rrethina u bënë një vend i rëndësishëm i një njësie më të madhe menaxhimi - tema.

Periudha nga shekulli X deri në XIV - periudha bizantine-sllave - ka një rëndësi të veçantë për historinë mesjetare të këtij rajoni. Rëndësia ekonomike e Shkupit është veçanërisht e rëndësishme pasi Shkupi ishte një kështjellë strategjike dhe kufitare. Shumë rrugë rajonale u prenë në rajonin e Shkupit dhe Shkupi ishte një degë kufitare bizantine për në Evropë dhe një seli e rëndësishme tregtare e Ballkanit. Shkupi në atë kohë kishte dy elemente - pjesën ushtarake-administrative dhe pjesën civile. Trashëgimia kulturore dhe shpirtërore gjithashtu varej prej tyre.

Kommenosi Bizantin i Shekullit XII është unik në stilin e tij të krijimtarisë në të gjithë Ballkanin dhe sot e kësaj dite ka tërhequr interes të paparë. Baza shpirtërore e krishterë e mëvonshme në stilin bazilik dhe baza e një kryqi të mbishkruar janë karakteristike.

Por, një gjë është e rëndësishme të thuhet për periudhën pas Bizantine: Duke forcuar Shkupin si një qendër strategjike ekonomike dhe politike, rrethinat e Shkupit, ku i përket bashkisë së tanishme të Studeniçanit, janë lënë pas dore.

Pas Luftës së Dytë Botërore dhe themelimit të Jugosllavisë, territori i Komunës së Studeniçanit i përket komunës së atëhershme të Kisela Voda. Në Shtator 1996 u miratua Ligji për Ndarjen e Re Territoriale të Republikës së Maqedonisë, duke themeluar 123 komuna nga 34 ekzistuesit e mëparshme, dhe Qyteti i Shkupit me Asamblenë e Qytetit. Tri komuna të reja të Zelenikovo, Studenicani dhe Sopiste dolën nga komuna ekzistuese Kisela Voda .⁴⁵

⁴⁵ <http://studenicani.gov.mk/?lang=mk> (29-11-2020)

3.2 Profili I komunës së Studeniçanit

3.2.1 Kryetari I Komunës

Kryetari aktual I komunës është Azem Sadiku.

Azem Sadiki u lind më 1 shkurt, 1971, në Studeniçan. Shkollën fillore e kreu në SHF „Naim Frashëri” në Studeniçan ndërsa të mesmen në gjimnazin matematiko-natyror “Xhevdet Doda” në Prishtinë. Studimet i ka vazhduar në Shkup në Universitetin “MIT” në drejtimin e biznesmenaxhmentit.

Ka punuar si kontabilist në ndërmarrjen familjare. Nga viti 2000-2005 ka qenë kryetar i komunës së Studeniçanit. Në periudhën prej 2007-2009 ka qenë drejtor i Shtëpisë së studentëve „Pellagonia” në Shkup. Ndërsa pastaj sërish u zgjodh kryetar i Komunës së Studeniçanit në mandatin e dytë në periudhën prej 2013-2017. Qytetarët e Komunës së Studeniçanit i dhanë besimin që për here të tretë të zgjidhet kryetar i Komunës së Studeniçanit përperiudhën2017-2021.

Është i martuar dhe baba i katër fëmijëve. Kryetari zgjidhet me zgjedhje të përgjithshme direkte me votim të fshehur në përputhje me ligjin për afat kohor 4-vjeçar. Kryetari detyrën e tij e kryen në mënyr profesionale.⁴⁶ Kryetar në kornizën e detyrave:

- e paraqet dhe e përfaqëson komunën
- kontrollon ligjshmërin e rregulloreve të këshillit
- i prezenton rregullat e këshillit në faqen zyrtare te komunës
- garanton implementimin e vendimeve të keshillit
- garanton kryerjen e obligimeve të cilat me ligj i janë leleguar komunës
- inicon dhe propozon sjelljen e rregullave në kompetenc të këshillit
- propozon buxhetin vjetor dhe llogarin vjetore të buxhetit komunal

⁴⁶ <http://studenicani.gov.mk/kryetari/?lang=mk> (29-11-2020)

- e realizon buxhetin e komunës
- emron drejtor të ndërmarrjeve publike të cilat i themeloi komuna në bazë të konkursit publik
- sjell vendim për përcaktimin e tatimit të pronës që gjendet në teritorin e saj
- mban evidencë për restorantet si edhe për orarin e punës së tyre të cilat punojnë në teritorin e saj
- kontraktin objekte me qira ose pjesë të objektit të institucioneve publike me ose pa pajisje
- obligohet menjëher ta informoj ministrin kompetente për kryerjen e punëve nga sfera e vetqeverisjes lokale për ndodhjen e kushtet për shpërbërjen e këshillit
- gjatë lëshimit të parakohshëm të këshillit deri në zgjedhjen e këshillit të ri i kryen obligimet në kompetencë të këshillit me kufizime të përcaktuara me ligj
- përgadit rebalans të buxhetit me qëllim të kapërcimit të paqendrueshmërisë financiare të komunës të cilin e miraton komisioni për kapërcimin e paqendrueshmërisë financiare të komunës
- rregullisht lajmron këshillin në kryerjen e obligimeve në kompetencë që i ka në përputhje me ligjin
- vendos për çështje juridike për drejtësi, detyrime dhe interesa për persona fizikë dhe juridikë në përputhje me ligjin
- sjell rregullore për sistematizimin e vendeve të punës të administratës komunale
- vendos për punsime, për të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në administratën komunale nëqoftë se nuk është rregulluar ndryshe me ligj
- garanton drejtësi dhe shfrytëzim ligjor, mirëmbajtje dhe mbrojtje të pronësisë së komunës në përputhje me ligjin dhe statutin

-kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe statut

Kryetari i paraqet rregullat e këshillit në faqen zyrtare të Komunës së Studeniçanit Kryetari garanton implementimin e vendimeve të këshillit. Kryetari është i obliguar këshillit të i dorzoj raport për zbatimin e vendimeve të sjellura nga ana e këshillit në xhdo tre muaj gjat vitit. Për kryerjen e obligimeve kryetari informon këshillin në rast nevojë së paku 2 dy herë branda vitit Nëqoftë se kryetari mendon se rregullorja e këshillit nuk është në përputhje me kushtetutën dhe ligjet obligohet për afat kohor prej 7 ditësh nga dita e dorzimit, me vendim ta ndaloj shpalljen e tij me çka do të i prezentoj arsyet e shfuqizimit. Këshilli obligohet për afat kohor prej 15-ditësh nga dita e shpalljes së vendimit nga paragrafi 1i këtij neni ta shqyrtoj dhe të vendos pas saj. Në qoftë se këshilli nuk vërteton normativin, kryetari obligohet ta shpall dhe njëkohsisht të ngris iniciativ për kushtetshmërin dhe ligjshmërin e neneve të kontestueshëm para gjykatës së Republikës të Maqedonis së Veriut. Për iniciativën e paragrafit 3 të këtij neni kryetari obligohet që ta informoj ministrin përkatëse për kryerjen e punëve të vetqeverisjes lokale. Kryetari i posazgjedhur merr detyrën nga i më parshmi me afat kohor prej 7-ditësh nga dita e zgjedhjes. Kryetari në mënyr profesionale kryen detyrën. Në kohën e kryerjes së detyrës kryetar nuk ka të derjt të kryej veprimtari tjetër profesion . Kryetari nuk mund te merret në prgjegjësi penale ose te arrestohet për shprehjen e mendimit në këshill. Kryetari vendos cili nga anëtarët e këshillit do ta zëvendëoj në raste pamundësie ose mosprzence në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj. Antarit të këshillit i pushon detyra antar i këshillit në kohen kur ai yvendëson kryetarin. Kryetari i këshillit nuk mund ta zëvendësoj kryetarin. Paga dhe kompenzimet tjera, si dhe kompenzimi antar i këshillit ai i cili e zëvendëson kryetarin përcaktohen me ligj. Kryetari nuk mund të emrohet anëtarë i organeve mbykqyrës, drejtues dhe i organeve kontrolluese të shoqatave tregtare dhe shërbimeve publike. Kryetari nuk mund të merr pjesë në procesin e vendimarrjes ku ai ose partneri i jetës, fëmijet, ose familjar të brezit të dytë të cilat kanë interes direkt apo indirekt financiar. Kryetari obligohet që ta informoj këshillin për interesin nga paragrafi dy i këtij neni. Në rastet e paragrafit të dytë të këtij neni vendos njëri nga anëtarët e këshillit i zgjedhur në mënyrën e njëjtë si kryetari i këshillit. Në raste pamundësie

ose mungese deri 6 mujore kryetarin e zëvendëson antari i këshillit të cilin e përcakton kryetari. Me afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së funksionit kryetari obligohet me vendim ta emroj antarin e këshillit i cili do ta zëvendësoj.

Vendimin nga paragrafi 2 ië këtij neni e paraqet në faqen zyrtare të komunës. Për ditën ngjarjes së pamundësis ose mungesën kryetari e informon kryetarin e këshillit. Anëtarit të këshillit i pushon detyra anëtarat i këshillit për kohën që e zëvendëson kryetarin.⁴⁷⁴⁸

3.2.2 Këshilli ikomunës

Këshilli është organi përfaqësues i qytetarëve. Këshillin e përbëjn 15 (pesmbëdhjet) antarë-përfaqësues të zgjedhur në mënyr të përgjithshme dhe direkte me vota të fshehura. Mandati i antarëve të këshillit është 4(katër) vjeçar. Anëtarit i këshillit mund të revokohet. Këshilli zgjedh kryetarin nga rradhat e këshillit me mandat katërvjeçar. Kryetari i këshillit i konvokon dhe i udhëheq seancat e këshillit ,përkujdeset për organizimin dhe punën e këshillit si dhe i firmos vendimet që i sjell këshilli me afat kohor tre ditor nga dita e sjelljes së tyre dhe i dorzon te Kryetari për publikim. Anëtarët e këshillit deklarojn dhe nënshkruajn betimin solem i cili është Unë (emri dhe mbiemri) bëj betimin solemn qe te drejtat dhe detyrimet sia anëtar i këshillit do të i kryej me përgjegjësi dhe gjat realiyimit të tyre do ta nderoj kushtetutën,ligjet,vendimet e këshillit dhe do ta mbroj rrendin kushtetues te Republikës së Maqedonis të Vriut. Kryetarit të keshillit në kryerjen e detyrës i ndihmon administrata e komunës. Këshilli i kryen këto obligime

1 Sjell statutin e Komunës

2Sjell rregulloren e këshillit

3 Sjell programën e punës

4Sjell buxhetin dhe llogaein përfundimtare të Komunës

⁴⁷ Statuti i komunës së Studeniçanit Neni 43 / 54 (29-11-2020)

5 Vërteton shumën e burimeve të saja nga të hyrat, për financimin e komunës ne kuadrin e definimeve ligjore.

6 Sjell plan detal dhe dokumentacion urbanistik per vendbanimen ne që gravitojnë në Komunë.

7 Sjell programë për regullimin e tokës ndërtimore

8 Sjell rregullore në fushën e mbrojtjes të mjedisit jetësor, asistencës sociale, mbrojtjen e fëmive, arsimimit, mbrojtje shëndetsore, mbrojtje kundër zjarit ne kuadër të detyrimeve të përcaktuara me ligje të veçanta ose në përputhje me programën nacionale.

9 Sjell program për mirëmbajtje rrugëve dhe rrugicave lokale

10 Sjell program për ndriçim publik

11 Sjell program për ndërtimi dhe mirmbajtje të ujsjellsit lokal

12 Sjell vendim për shfrytëyimin e tregjeve publike

13 Rregullon mënyrën e pastrimit të oxhaqeve.

14 Rregullon hapsirën publike për parkim dhe mënyren e shfrytëyimit të aspektit lokal

15 Sjell program mirëmbajtje dhe shfrytëyimin parqeve dhe hapsirave tjera të aspektit lokal

16 Rregullon mirëmbajtjen e varezave

17 Miraton program për mirmbajtjen dhe shfrytëyimin e kuritave të lumit

18 Rregullon dhe organizon sferën e veprimit dhe mënyrën e kryerjes të detyrave të administratës së komunës me propozim të Kryetarit

19 Themelon nërmarje publike dhe përcjell punën e tyre

- 20 Emëron antar të këshillave drejtues te shërbimeve publike që i themelon
- 21 Miraton program pune dhe plan financiar të ndërmarrjeve publike që ka themeluar
- 22 Miraton raport për realizimin e buxhetit dhe llogari vjetore të komunës, si edhe raport për realizimin e programës vjetore të komunës
- 23 Vendos për dhënien e lejeve për kryerjen veprimtarive të interes publik të aspektit lokal në pajtim me ligjin
- 24 Miraton llogarive vjetore dhe raportet e punës te ndërmarrjeve që ka themeluar
- 25 Vendos mënyrën e pronësis që posedon komuna
- 26 Vendos për mënyrën e kryerjes të kontrollit financiar të buxhetit së komunës në përputhje me ligjin
- 27 Me vendim sjell vlerën e taksës komunale
- 28 Formon komision për vlersimin tatimit të vlerës së tregut, tatimin e pronësis dhe i vendos shkallët tatimore
- 29 E rregullon orarin e punës të veprimtarive artizanale në varësi me traditat vendore në komunë
- 30 Bën planin e masave dhe aktivitetet që do të i merr për kapërcimin e joqendrueshmëris financiare të komunës i propozuar nga Kryetari që është përgjegjës për komunën
- Zgjedh personin që do udhëheq me njësin rajonale te Ministris së brendshme ne komun në pajtim me ligjin
- 32 Analizon dhe miraton raportin vjetor të sigurimit publik ne njësin komunale, të cilin e sjell Ministria e brendshme dhe avokati i popullit

33 Mund të i jep sugjerime personit që udhëheq me njësin rajonale të ministris se brendshme në sferen e siguris publike dhe të trafikut

34 Zgjedh dhe shkarkon kryetar të këshillit

35 Formon komisione të përkohshme

36 Realizon autorizime të veçanta ne përputhje me ligjin në bazë të të mirës publike dhe në bazë të pasurive natyrore në rajonin e komunës

37 Vendos mirënjohje dhe dhurata komunale

38 Jep propozime për ligjet që sjellen në komunë

39 Bën zgjedhje dhe emrime në kompetenca të saja

40 Sjell vendime tjera për punë në kompetenca të saja

41 Bën edhe punë tjera

Këshilli mund të punoj nëse në seancë prezenton shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Këshilli vevdos me shumic votash nga anëtarët e pranishëm në këshill,por jo më pak se nje e treta të numrit të anëtarëve të këshillit,nëqoftese me statun nuk është e parapar shumicë e veçant,votimi ne seancë te këshillit është publik,përveç nëse këshilli nuk vendos për çështje të posaçme votimi të jet i fshehur. Statuti,buxheti,llogarija vjetore e buxhetit dhe rregullorja miratohet me shumic votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të këshillit. Seancë e jashtëzakonshme caktohet për çështje sigurie të qytetarëve,për gjëra që kanë ngjarë për shkak të rethanave të jashtëzakonshme(zjar,përmbytje terrmet e tj) dhe gjatë vizitës të delegacioneve të huaja, kur përfaqshues i të njejtave donë që të i drejtohet anëtarëve të këshillit. Sencë të jashtëyakonshme thëret kryetari i këshillit me vetë iniciativë,me propozim të 1/3 të anëtarëve të këshillit,ose me propozim të kryetarit.

Ftesat për seancë dhe propozime rendit të ditës iu dorzohet anëtarëve të këshillit në menyrën më të shpejt, para se të fillojnë me punë anëtarët e këshillit votojnë arsyen e caktimit të seancës pa hapur debat për materialin. Anëtarët e këshillit kanë të drejtë dhe detyrim të prezantojnë dhe të marrin pjesë në punën e këshillit si dhe në komisionet e saja të përkohshme dhe të përhershme. Anëtarët në seancë të këshillit kanë të drejtë të japin idetë dhe të shtrojnë pyetje Kryetarit të Komunës. Antari i këshillit nuk mund të merret në përgjegjësi penale ose të arrestohet për mendimin e shprehur ose për votimin në këshill. Punëdhënësi është i detyruar ta lejoj nga puna profesionale anëtarin e këshillit për të prezantuar në seancën e këshillit dhe në komisionet ku ai është anëtar. Anëtarët e këshillit kanë edhe të drejta dhe detyrime tjera të definuara me statut dhe rregullore tjera në pajtim me ligjin. Antari i këshillit nuk mund të marrë pjesë në proceset e vendimit për çështjet ku ai ose partneri i jetës, fëmiju ose fqiu i shkallë së dytë në linjë ansore kanë interes financiar. Anëtarin e këshillit është i detyruar që t'informoj këshillin për çështjet ku ai ka interes financiar ose interes personal. Anëtarin e këshillit nuk mund të punsohet në administratën komunale në komunën ku ai punon. Me ditën e punësimit në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni do të konsiderohet se antari i këshillit ka dhënë dorëheqje. Anëtarin e këshillit i punësuar në ndërmarrjet publike që i ka themeluar komuna nuk mund të marrë pjesë në procesin e vendimarrjes për çështjet që vendosen në shërbimin (ndërmarrjen) publik ku ai punon. Anëtarin të këshillit i ndërprihet mandati para kohës që është i zgjedhur

-nëse jep dorëheqje

-në rast vdekje

-nëqoftëse është i denuar me vendim gjykatë për veprë penale me burg me afat kohor mbi 6 muaj

-nëqoftë se vinë në kundërtënie funksioni antar i këshillit në pajtim me ligjin të zgjedhjeve lokale.

-nëqoftë se me vendim gjykate i është mohuar një pjesë mundësive dhe nëqoftë se nuk është banor i komunës.

Këshilli në seancën e radhës do ta konstatojë arsyen dhe ditën e ndërprerjes të mandatit të anëtarit të këshillit dhe atë:

-në raste si paragrafi 1 alineja 1 nga dita e mbajtjes së seancës dhe në rastet si paragrafi 1 alineja 2,3,4,5 dhe 6 nga dita e përmbushjes së kushteve.

Antarit të këshillit mund ti merret mandati pa arsye mungon 3 seanca rreshtazi. Për arsyetimin e mosprezencës nga paragrafi 3 i këtij neni vendos këshilli me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve në këshill. Për ndërprerjen e çështjeve që i ka në kompetencë këshilli formon komisione. Komisionet e këshillit formohen si të përhershme po ashtu edhe të përkohshme. Mandati i komisioneve të përhershme zgjat sa vet mandati i anëtarëve të këshillit. Përbërja dhe kohëzgjatja e mandatit të komisioneve të përkohshme do të vendoset me vendim për formimin e tyre. Komisione të përhershme të këshillit janë:

-Komisioni për formimin e buxhetit dhe zhvillimin rural ekonomik

-komisioni për urbanizëm, veprimtaritë komunale dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

-komisioni për shtëpi dhe shërbime publike.

-komisioni për statut dhe rregullore

-komisioni për mandate zgjedhje dhe emrim.

-komisioni për mirënjohje dhe dhurata.

-komisionet përbëhen nga 3 deri 5 anëtarë të këshillit

Komisionet në këshilli:

-debatojnë për çështjet për të cilat janë formuar

-japin mendime dhe propozime deri te këshilli

-i shqyrtojnë propozimet e kryetarit të kumunës,anëtarëve të këshillit,iniciativat e qytetarëve për fushën për të cilën janë formuar.

Komisioni për financim,buxheti,dhe zhvillimi rural ekonomik i shqyrton çështjet në lidhje me financimin e komunës,buxhetin dhe llogarin vjetore,relizon kontroll mbi punën financiare të komunës,jep propozim në përgaditjen e ndryshimeve për rebalanc të buxhetit i analizon dhe propozon në lidhje me planifikimin dhe programimin të zhvillimit rural ekonomik,për uljen e papunësis formimin e zonave ekonomike dhe aktivitete tjera.Komisioni për urbanizëm,veprimtari komunale,mbrojtjen e mjedisit jetësor i shqyrton çështjet në lidhje me planifikimin urbanistik,infrastruktur komunale dhe relizimin e tyre në komunë,për çështjet e punës të shërbimëve te themeluara nga ana e komunës si dhe ndermarrjet tjera për rregullim të përbashkët komunal të qytetit të Shkupit dhe vendbanimeve si dhe për çështjet e mbrojtjes të mjedisit jetësor dhe natyrës. Komisioni për shërbime dhe institucione publike i trajton çështjet në kompetencë të komunës,sa i takon kulturës,sportit dhe rekreacionit,mbrojtjes sociale dhe fëmimore,arsimimit mbrojtjes shëndetsore,sigurimit publik dhe trafikor si dhe mbrojtja kundër zjarit.Propozon metodologji për caktimin e kriterëve në ndarjen e mjeteve për çerdhet,shkollat fillore,sportin ndihmesës sociale dhe mbrojtjes së fëmive dhe aktiviteteve tjera të finansuara nga komuna.Komisioni për statut dhe rregullore:

-përcakton propozimin e statutit,i shqyrton iniciativat për propozim ndryshimimet e statutit dhe përcjell zbatimin e tij si edhe çështjet e rëndësishme të karakter statutor. -e përcakton propozimin e rregullores të këshillit

-përgdit propozim mendim me propozim ligjet të cilat i përkasin komunës dhe shqyrton akte tjera të përgjithshme në kompetencë të këshillit

Komisioni për emrime,shkarkim dhe çështje mandatore

-Shqyrton dhe përgadit propozime të cilat i përkasin çështjeve për emrime dhe mandate 71

-shqyrton dhe përgadit propozime për zgjedhje, emrime, shkarkime në kompetencë të këshillit

-përcakton paga, kompenzime dhe të hyra tjera për persona të zgjedhur ose të emruar

-përcakton shumën e kompenzimit të rrogave si dhe harxhimet ditore të anëtarëve të këshillit, si dhe për harxhimet e bëra gjat kryerjes së detyrës të cilën ia ka besuar këshilli.

Kryetarin dhe anëtarët e komisionit i zgjedh këshilli nëm seancën e saj të parë

Komisioni për mirënjohje dhe dhurata

-merr iniciativa dhe propozime për mirënjohje si dhe i shqyrton iniciativat dhe propozimet për mirënjohje të dorzuara nga subjektet tjera

-jep mendim për propozimet e dorzuara

- jep propozim dhe i shqyrton ato për zgjedhjen qytetar të nderit i komunës.

-ben organizim solemn në dorësimin e mirënjohjeve dhe dhuratave si dhe e informon publikun përmes mjeteve të informimit.

Kryetarin dhe anëtarët e dhe komisionin i zgjedh këshilli me propozim të komisionit për çështjen e mandateve, zgjedheje dhe emrim.

Partit politike që participojnë në këshill në mënyrë proporcionale duhet të përfaqësohen në numrin e përgjithshëm të anëtarëve nëpër gjitha komisionet.

Mënyrën e funksionimit të komisioneve përsëafërmi e përcakton rregullorja e këshillit.

Shpërbërja e këshillit:

1 këshilli shpërbëhet nëse për shpërbrjen e tij shprehet shumica e antarëve të këshillit

2 këshilli shpërbëhet edhe nëse:

-nëse përsëri sillet vendim i cili më parë ishte anuluar nga gjykata kushtetuese e RMV

-sillet vendimi me te cilin rezikohet suveriniteti dhe integriteti teritorial i RMV

-nuk mblidhet për periudhë më të gjatë se gjashë muaj

-nuk e sjell buxhetin dhe llogarin vjetore të buxhetit deri 31 marrs vitin vijues⁴⁹

Përbërja aktuale e këshillit të komunës:

1 Mujedin Abazi (PDSH)

2 Turkjan Saliu (PDSH)

3 Nefail Bilalovski (PDSH)

4 Sara Mustafa (PDSH))

5 Nehat Elmazi (BDI)

6 Kadir Rushidi (BDI)

7 Zejnepe Saqipi (BDI)

8 Kujtim Ferati (ASH)

9 Nusret Pashaliq (LSDM)

10 Elvira Mekiq (LSDM)

11 Xhevat Azemofski (LSDM)

12 Amit Memed (TDP)

13 Ibrahim Memedi (LB)

14 Azem Jonuzi (LB)

15 Zulejha Ali (LB)⁵⁰

3.2.3 Administrata komunale

Në administratën komunale në komunën e Studeniçanit marrin pjesë:

Sekretari:Burhanedin Nuhiju u lind më 17.01.1988 në Maranë të Komunës së Studeniçanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje ndërsa arsimin e mesëm në Shkollën Ekonomike Juridike të qytetit të Shkupit “Arseni Jovkov”. Studimet deri-diplomike i mbaroi në Fakultetin Juridik Iustinianus Primus në Universitetin Shën Qirili dhe Metodi, ndërsa studimet post-

⁴⁹ Statuti i komunës së Studeniçanit Neni 20/21/22/23/24/25/26/27/28/29/30
31/32/33/34/35/36/37/38/39/40/41/42 (29-11-2020)

⁵⁰ <http://studenicani.gov.mk/kryetari/?lang=mk> (29-11-2020)

diplomike i mbaroi në Univerzitetin FON, gjithashtu në fakultetin juridik në drejtimin e së drejtëscivile.

Objekt studimi i disertacionit të tij ishte “Vetëqeverisja lokale dhe informacionet me karakter publik”.Përveç gjuhës shqipe dhe gjuhës maqedonase ai zotëron edhe gjuhën angleze dhe atë turke. Burhanedin Nuhiju ka ndjekur disa trajnime si brenda poashtu edhe jashtë vendit. Në të njëjtën kohë ai është aktiv edhe në sektorin civil tash e ca vite. Nga viti 2009 deri në vitin 2013 ka punuar si mësimdhënës në SHF. Naim Frashëri-Studeniçan ndërsa nga viti 2013 e këndej punon në Komunën e Studeniçanit. Kurse në janar të vitit 2018 iu besua posti i sekretarit të Komunës së Studeniçanit.

Ejup Abazi:Udhëheqës I njësisë për menaxhim me resurset njëzore

Nuri Sadiki:Udhëheqës I njësis për çështje financiare

Iljaz Muhaxheri:Udhëheqës I njësis për urbanizëm,veprimtari komunale dhe ambient.

Orhan Shabani:Udhëheqës in njësis për zhvillim ekonomik lokal.⁵¹

Aktivitetet

Rikonstruimi I rrugës Kitkë

Ka përfunduar edhe asfaltimi i rrugës për në Kitkë, pjesa prej në f.Koliçan të epërm deri te varrezat e f.Uji i kuq, me këtë u përfundua rikonstruksioni i kësaj pjese.

